

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6153
E shtunë, 31 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria miratoi
Projektligjin mbi ndarjet
buxhetore për vitin 2021

I FAQE 8



REKORD RASTESH ME COVID-19 DHE KATËR TË VDEKUR
NË KOSOVË NË 24 ORËT E FUNDIT

I FAQE 4-5

NUMRI I RASTEVE TË INFETIMIT ME COVID PO SHËNON RRITJE ALARMANTE NË KOSOVË

Republika e Kosovës ka regjistruar të premten rekord rastesh të infektiveve me Covid. Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit janë shënuar 418 raste të reja të infektimit me Covid, katër vdekje dhe 67 pacientë janë shëruar nga kjo sëmundje. Pas shtimit të rasteve, ka reaguar Institut Kombëtar i Shëndetësisë Publike, duke i ftuar qytetarët që t'i respektojnë masat anti-Covid. Sipas këtij Instituti, rritja e rasteve në vend po ndodh për shkak të mosrespektimit të masave që janë maska, distanca dhe higjiena



DIPLOMON GJENERATA E 55-TË E KADETËVE
POLICORË TË POLICISË SË KOSOVËS

POLICISË SË KOSOVËS I BASHKOHEN 426 POLICË TË RINJ

Të premten Policisë së Kosovës i janë bashkëngjitur 426 policë të rinj. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë

se policët e rinj do të janë ndihmësë e madhe për punën në terren dhe nga të njëjtët ka kërkuar angazhim shështë, sidomos në këtë kohë të

pandemisë. Nga data 2 nëntor 2020 policët e rinj do të fillojnë të shërbejnë në kuadër të Policisë së Kosovës



'DARDAFON'-i LË PA PAGË
MBI 2 300 PUNËTORË TË
'TELEKOM'-it

I FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRICESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.pricesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

infinity
INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



OPINION

SHAIP KAMBERI, NJË KAMBAÑË E NDËRGJEGJES SË FJETUR



Nga Mehmet PRISHTINA




AKTUALE



NJË TËRMET I FUQISHËM KA TRONDITUR TURQINË DHE GREQINË

I FAQE 2
AMENDAMENTIMET E SHPESHTA
TË LIGJEVE I BËJNË ATO
KOMPLEKSE DHE VËSHTRIRË
TË ZBATUESHME

I FAQE 6
PROKURORIA NË GJILAN NGRIT AKTAKUZA NDAJ GJASHTË 'VETERANËVE TË RREJSHËM'



KOSOVA T'I RRISË INVESTIMET NË SEKTORIN KIBERNETIK DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE

I FAQE 9
KRASNIQI: JEMI TË PËRKUSHTUAR QË TA RRISIM PËRKRAHJEN PËR BIZNESET

I FAQE 15
SPORT
FFK-ja: I KEMI NDIHMUAR FINANCIARISHT KLUBET E SUPERLIGËS

Një tërmet i fuqishëm ka tronditur Turqinë dhe Greqinë

ANKARA, 30 TETOR - Të paktën katër njerëz kanë vdekur dhe 120 të tjerë janë plagosur nga tërmeti i fuqishëm që ka goditur të premten Turqinë, ka raportuar agjencia DPA. Të paktën pesë ndërtesa u shembën dhe katër njerëz u shpëtuan të gjallë nga rrënojat e një ndërtese të shembur shtatëkatëshe në rrëthin Bayraklı, ka njoftuar transmetuesi shtetëror TRT.

Tërmeti i fuqishëm në Detin Egje ka trondit Turqinë dhe Greqinë. Ministri i Brendshëm i Turqisë ka thënë se gjashtë ndërtesa në provincën

perëndimore të Izmirit u shkatërruan.

Lëkundja raportohet të ketë shkaktuar një cunami të vogël në portin e Samos.

Organë për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Emergjencave të Turqisë ka njoftuar se tërmeti i së premtes kishte një magnitudë 6.6 të shkallës të Riherit.

Qendra Sizmologjike Evropiane-Mesdhetare ka njoftuar se tërmeti kishte magnitudë prej 6.9 shkallësh me një epikentër 13 kilometra në verilindje të ishullit grek të Samos. Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të

Bashkuara njoftoi për një fuqi 7 shkallë të Riherit.

Mediat turke shfaqen pamje të rrënojave të një ndërtese shumëkatëshe në Izmirin qendror dhe njerëz që ngjiteshin në të pér të arritur tek ekipe e shpëtimit. Pamjet tregonin edhe pér tym në disa pika në Izmirin qendror.

Mediat turke kanë njoftuar se tërmeti u ndje në të gjithë rajonet e Egjeut dhe Marmaras, ku ndodhet edhe qyteti i Stambollit. Guvernatori i Stambollit tha se nuk ka raporte pér dëme.



Tërmeti u ndje gjithashtu në të gjithë ishujt lindorë grekë, madje edhe në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Mediat greke thanë se banorët e Samos dhe të ishujve të tjerë u larguan nga shtëpitë e tyre. Nuk ka raportime të menjëherësme pér të plagosur.

'Dardafon'-i lë pa pagë mbi 2 300 punëtorë të 'Telekom'-it



PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - "Telekomi" i Kosovës, në një komunikatë për media, ka njoftuar se, edhe pse Qeveria e Kosovës ka pasur komunikim me zyrtarët e "Dardafon"-it, ata nuk kanë arritur marrëveshje.

"Dardafon"-i për herë të dytë brenda gjashtë muajve ka zbrazur llogarinë e "Telekom"-it të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe Qeveria e Kosovës ka zhvilluar takime për ta bindur "Dardafon"-in që të nënshkruejë marrëveshje për të cilën tashmë ishin marrëveshës në prani të kryeministrat dhe

të ministrit të Ekonomisë dhe të Ambientit. Marrëveshja mes tyre ishte që pagesa të bëhej në afat prej 24 muajsh por, si duket, në fund nuk arriti ta bindë "Dardafon"-in për nënshkrim të marrëveshjes, i cili fillimisht ka bllokuar llogaritë, ndërsa sot i ka zbrazur.

Me zbrazjen e sotme të llogarisë së "Telekom"-it, "Dardafon"-i fillimisht ka lënë pa pagë 2 300 punëtorë të "Telekom"-it dhe më shumë se 1 000 të Postës së Kosovës. "Telekomi" në këtë rast ka qenë i pafuqishëm që të marrë

çfarëdo vendimi që do ta parandalonte një gjë të tillë. "Me këtë veprim janë rezikuar në tërësi të gjitha shërbimet tonë, duke përfshirë edhe shërbimet e institucioneve të sigurisë së vendit. Pra, përvëç të tjerash, me këtë veprim është rezikuar siguria kombëtare. Kërkojmë urgentisht nga qeveria që të reagojë dhe ta zgjidhë këtë çështje, thuhet në komunikatën e lëshuar për media nga "Telekom"-i", është bërë me dije në komunikatën e "Telekom"-it dërguar mediane.

ShBA-ja, shifër rekordë të rasteve me koronavirus

NJU-JORK, 30 TETOR - Shtetet e Bashkuara shënuan të enjten shifër rekordë të rasteve të reja me koronavirus: mbi 91 000 për 24 orë. Shifra e tejkalon rekordin e mëparshëm prej 84 169 rastesh, të vendosur më 23 tetor.

ShBA-ja është vendi më i prekur në botë nga koronavirusi, me rreth 9 milionë raste në total dhe me mbi 228 000 viktima. "Jemi në një trajktore shumë të vështirë. Po shkojmë në drejtim të gabuar", tha drejtori i Institutit Kombëtar për Alergji dhe

Sëmundje Infektive, Anthony Fauci.

Rastet janë në rritje në 47 shtete dhe pacientët janë duke ngarkuar spitalet në të gjithë vendin, tha Fauci në një intervistë për kanalin televiziv CNBC.

Numri i pacientëve me koronavirus, të shtruar në spitalet e ShBA-së, ishte rreth 46 000 më 29 tetor.

Në Evropë shumë vende janë detyruar t'i forcjnë kufizimet për shkak të rritjes së numrit të

rasteve me koronavirus.

E fundit - Franca është futur në izolim kombëtar.

Të 65 milionë njerëzit e Francës janë kryesishët të mbyllur në shtëpi, nën urdhrin e shpallur këtë javë nga presidenti Emmanuel Macron.

Masat prekin baret, restorantet, ndërsa shkollat deri në nivelin e mesëm do të qëndrojnë të hapura. Në të gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 45 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 1.1 milion kanë vdekur dhe mbi 30 milionë janë shëruar.



Ndërron jetë ish-kryeministri i Turqisë

STAMBOLL, 30 TETOR - Mesut Yilmaz, 73 vjeç, vdiq në spital, ku po trajtohej për kancer të mushkërive. Zyra e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan e cilësoi Yilmazin si "një nga figurat më të shquara të jetës politike në Turqi". Yilmaz ishte ministër i

Jashtëm gjatë viteve 1980 dhe tri herë kryeministër gjatë viteve 1990. Mandatet e Yilmazit kanë mbuluar koalicionë të paqëndrueshme, skandale politike dhe një konflikt në rritje me Partinë e jashtëligjshme të Punëtorëve të Kurdistanit

(PPK). Mandati i tij i fundit më 1997-99 është pëershkuar me një përcarje të madhe me Sirinë fqinje. Në vitin 1998 Yilmaz ka shkaktuar zemërim të gjithë botën arabe, pasi ka kërcënuar se do "t'ia nxjerrë sytë" presidentit të atëhershëm

sirian, Hafez al-Assad, për shkak të mbështetjes për PPK-në. Yilmaz ka udhëhequr partinë Anap (Mëmëdheu) përpëra se të pësonte humbje të madhe në zgjedhjet e vitit 2002, kur Partia për Drejtësi dhe Zhvillim e Erdoganit ka hyrë në pushtet.



Diplomon gjenerata e 55-të e kadetëve policorë të Policisë së Kosovës

Policisë së Kosovës i bashkohen 426 policë të rinj

Të premten Policisë së Kosovës i janë bashkëngjitur 426 policë të rinj.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se policët e rinj do të jenë ndihmesë e madhe për punën në terren dhe nga të njëjtët ka kërkuar angazhim shështë, sidomos në këtë kohë të pandemisë. Nga data 2 nëntor 2020 policët e rinj do të fillojnë të shërbijnë në kuadër të Policisë së Kosovës



**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Të premten ka diplomuar

gjenerata e 55-të e kadetëve policorë të Policisë së Kosovës. Bazuar në situatën aktuale të pandemisë Covid-19, nuk është mbajtur ceremonia e

diplomimit. Diplomimi është bërë në grupe të vogla - klasa, në hapësirat e Akademisë, organizuar nga Drejtoria për Trajnimet Themelore -

Divizioni i Trajimeve i Policisë së Kosovës.

Në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe u. d. drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, i cili ka thënë se sot Policisë së Kosovës po i bashkëngjiten 426 policë të rinj që do të jenë ndihmesë e madhe për punën në terren dhe nga të njëjtët ka kërkuar angazhim shështë sidomos në këtë kohë të pandemisë. "Duke marrë parasysh se PK-ja ka një imazh të mirë te qytetarët, ju duhet të kontribuoni që akoma më shumë të ngrihet niveli i besueshmërisë te qytetarët. Policëve të rinj ju dëshiroj shëndet dhe suksese në detyrën e re në shërbim të qytetarëve", ka thënë Mehmeti.

Me këtë rast, 426 policët e rinj i pranuan certifikatat dhe dhanë betimin zyrtar se do ta zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, se do t'i mbrojnë sovranitetin

dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, duke treguar profesionalizëm, përgjegjësi dhe ndershmëri në interes të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtë trajnim së bashku me kadetët policorë e kanë përfunduar edhe pesë pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga komponenti i Policisë Ushtarake. Gjithashtu, janë ndarë mirënjojje për 14 kadetët policorë si kapitenë të klasave dhe 20 kadetëve policorë për rezultatet më të larta të arritura gjatë kohëzgjatjes së trajnimit.

Nga data 2 nëntor 2020 policët e rinj do të fillojnë të shërbijnë në kuadër të Policisë së Kosovës, duke vazhduar me pjesën e programit të trajnimit fushor për policët e rinj në stacione policore në kohëzgjatje prej dy vjet nën mbikëqyrje të instrukturëve praktikë /fushorë të Policisë së Kosovës.




Policia përgatitet për zgjedhjet në Podujevë dhe në Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka pritur të premten në takim ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti. Takimi është zhvilluar në kuadër të përgatitjeve të zgjedhjeve të ashtëzakonshme për kryetar

në Komunën e Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut si dhe të bashkërendimit të aktiviteteve me institucionet e tjera të Republikës së Kosovës.

Në emër të KQZ-së, kryetarja Daka ka shprehur mirënjojje për angazhimin e Policisë së Kosovës në aspektin e sigurisë në proceset e kaluara zgjedhore, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim

ndërinstitucional me qëllim të zbatimit të ligjit. Në anën tjetër, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se Policia e Kosovës, në kuadër të përgjegjësive institucionale dhe ligjore, është e gatshme për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit zgjedhor.



AMBULANCA P CORONAVIRU

Rekord rastesh me Covid-19 dhe katër të vdekur në Kosovë në 24 orët e fundit

NUMRI I RASTEVE TË INFJEKTIMIT ME COVID PO SHËNON RRITJE ALARMANTE NË KOSOVË

Republika e Kosovës ka regjistruar të premten rekord rastesh të infektimeve me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të

fundit janë shënuar 418 raste të reja të infektimit me Covid, katër vdekje dhe 67 pacientë janë shëruar nga kjo sëmundje. Pas shtimit të rasteve, ka reaguar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, duke i

ftuar qytetarët që t'i respektojnë masat anti-Covid. Sipas këtij Instituti, rritja e rasteve në vend po ndodh për shkak të mosrespektimit të masave që janë maska, distanca dhe higjiena

**EPOKA
ERE** **Muhamed KOÇI**

PRISHTINË, 30 TETOR - Rritja e numrit të rasteve të infektuar me Covid-19 të premten ka arritur kulmin në Kosovë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë regjistruar 418 raste të reja të infektimit.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë shënuar edhe katër viktima. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 608 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 418 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar

katër raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast Klinika e Kardiologjisë, QKUK, 1 rast Mjekimi Intensiv Qendor, QKUK, 1 rast Klinika e Pulmologjisë, QKUK dhe 1 rast Spitali i Përgjithshëm Prizren), ka njoftuar IKShPK-ja.

Numri total i rasteve pozitive është 19 328 raste nga 92 706 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 678 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 67 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 15 434 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 3 126. Komuna me më së shumti raste vazhdon të jetë Prishtina, me 188 raste. Pastaj renditet Komuna e Gjakovës me 32 raste, Komuna e Fushë-Kosovës 31 raste, Komuna e Podujevës 28 raste, Komuna e

Gjilanit 27 raste, Komuna e Pejës 18 raste, Komuna e Deçanit 16 raste, Komuna e Prizrenit 13 raste, Komuna e Suharekës 12 raste, Komuna e Lipjanit 10 raste, Komuna e Drenasit 7 raste, Komuna e Obiliqit 7 raste, Komuna e Klinës 6 raste, Komuna e Shtimes 5 raste, Komuna e Graçanicës 4 raste, Komuna e Ferizajt 3 raste, Komuna e Vushtrrisë 3 raste, Komuna e Kamenicës 2 raste, Komuna e Malishevës 2 raste, Komuna e Rahovecit 2 raste dhe me nga një rast Komunat e Skenderaj dhe e Vitisë.

IKShPK-ja: Mosrespektimi i masave po ndikon në rritjen e rasteve

Pas rritjes të rasteve ka reaguar

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK), duke kërkuar nga qytetarët që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore kundër Covidit. "Të dashur qytetarë, mos lejoni mbylljen e të gjithëve për pakujdesinë e disave. Kudo që vëreni persona që nuk iu përbahen rekomandimeve, i këshilloni. Këshillimi është obligim qytetar. Ju lutemi përkujdes të shtuar. Ju lutemi të keni kujdes, sepse rreziku akoma ekziston. Virusi është kudo. Virusi vret! Ju lutemi përbahuni rekomandimeve! Mos e nënverherësoni virusin. Pakujdesia na dërgon shumë shpejt në mbingarkesën e institucioneve shëndetësore dhe shtimin e rasteve fatale", ka vlerësuar instituti, duke shtuar

se asnjë vend në botë nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe infrastrukturë spitalore ta përballojë shtimin e rasteve. Sipas IKShPK-së, rritja e rasteve në vend po ndodh për shkak të mosrespektimit të masave që janë maska, distanca, higjiena! "Numri i rasteve javën e fundit ka pësuar rritje brengosëse si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave. Ju lutemi të keni kujdes në mbajtjen e maskave, mbani distancë dhe higjienën personale. Këto ditë vërehet fluks i shtuar i lëvizjes së qytetarëve kudo nëpër Kosovë. Kjo është sjellje e rrezikshme dhe lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mosrespektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së

dhe mosbatimit të rekomandimeve. Inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin anti-Covid-19, Ligjin për inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, duke u mbështetur në Manualin përluftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të mosbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka bërë me dije instituti.

Kosova do ta sigurojë vaksinën për Covid-19 përmes Bankës Botërore

Shëndetësisë", ka bërë me dije IKShPK-ja. IKShPK-ja ka theksuar se pakujdesia e disa qytetarëve gjatë këtyre lëvizjeve dhe aktivitetave, shton rrezikun e përhapjes së infeksionit. "Apelojmë te qytetarët, institucionet publike e private, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmhängjen e përhapjes në hapësirat e mbyllura. Burimet e infeksionit janë të shpërndara në institucione publike, private, agjenci, shkolla dhe amvisëri të cilët kanë mundur të infektohen kudo prej vendit të punës në institucione publike dhe private, gastronomisë, supermarketeve, ku pjesa dërrmuese shihet pa maska në vende të punës", ka apeluar IKShPK-ja, duke shtuar se përpjekja e madhe e përbashkët e derisotme mund të shkojë huq për shkak të pakujdesisë së mospërbajtjes së tri rregullave themelore, mbajtjen e distancës fizike, mbajtjen e maskave dhe larjen e duarve me kujdes disa herë në ditë, për 20-30 sekonda. "Çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se Kosova do ta sigurojë vaksinën kundër Covid-19, kurdo që ajo të jetë e gatshme, përmes Bankës Botërore. Në një konferencë për media të premten, pas mbledhjes së qeverisë, Bajrami ka thënë se vaksina do të sigurohet përmes kredive nga Banka Botërore. "Ne jemi në negociata me Bankën Botërore që të hyjmë në një projekt të sigurimit të vaksinës anti-Covid dhe me këtë do të jemi ndër vendet e para që do ta marrim sapo të dalë kjo vaksinë", është shprehur Bajrami. Ajo ka shtuar se në takimin e fundit me Bankën Botërore, me pjesëmarrjen e më shumë se 50 shteteve u është bërë një prezantim i një numri të madh të vaksinave. "Kjo është një pako e vaksinave që Banka Botërore do ta blejë për një numër të madh të shteteve nuk do të bëhet prokurim specifik për Kosovën, por do të jetë për një numër të madh të shteteve. Banka Botërore është bankë dhe kjo do të bëhet përmes kredive dhe jo përmes donacioneve, mirëpo kushtet janë të favorshme", ka deklaruar ministria Bajrami.



Fillon aplikimi për regjistrim për votim jashtë vendit për zgjedhjet në Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se të premten ka filluar periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe të Mitrovicës së Veriut. Afati për aplikim përmbyllat më 7 nëntor. Gjatë kësaj periudhe, shtetasit e Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës dhe që iu takojnë këtyre dy komunave, mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës. Gjithashtu, edhe ata/ato që nuk kanë shtetësinë e Republikës së Kosovës, por që kanë të drejtë të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për Shtetësi, mund të aplikojnë. Informacionet e hollësishme dhe si të aplikohet për regjistrim janë publikuar në faqen e



KQZ-së. Të gjithë ata/ato që regjistrohen suksesshëm si votues jashtë vendit mund të votojnë gjatë periudhës së votimit përmes postës e cila fillon më 20 nëntor dhe përfundon më 27 nëntor 2020. Të gjithë votuesit që janë regjistruar suksesshëm si votues jashtë vendit në periudhën e zhvilluar më herët (16-23 shkurt) për të votuar në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Podujevë duhet të aplikojnë sërisht për regjistrim dhe vetëm pas regjistrimit do të mund të marrin pjesë në votimin përmes postës.

Prokuroria në Gjilan ngrit aktakuza ndaj gjashtë 'veteranëve të rrejshëm'



GJILAN, 30 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan ka njoftuar të premten se ka ngritur aktakuzë kundër gjashtë të pandehurve për shkak të veprës penale "legalizim i përbajtjes së rreme". "Sipas aktakuzave, të pandehurit F. A., R. R., A. A., I. R., A. H. dhe F. D. kanë vënë në lajthim Komisionin Qeveritar të Republikës së Kosovës dhe Ministrinë për Mirëqenie

Sociale në atë mënyrë që i kanë plotësuar me të dhëna të pavërteta aplikacionet e dedikuara për pjesëmarrësit aktivë në UÇK se, kinse, kanë qenë të angazhuar në aktivitete ushtarake të logistikës, ku këto aplikacione i kanë dorëzuar në Shoqatën e Veteranëve të Luftës në Gjilan, me ç'rast të pandehurve iu është njohur statusi i veteranëve të luftës dhe e drejta në pension mujor prej 170 eurosh", është thënë në komunikatë për media të Prokurorisë. Prokuroria i ka konsideruar këta persona si "veteranë të rrejshëm". Në njoftim është thënë se të pandehurit e kanë dëmtuar buxhetin e Kosovës në shumë prej 44.810 eurove. Prokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, pati thënë më 2018, se 19 mijë veteranë kanë fituar këtë status kundërligjshëm në Kosovë.

Amendamentimet e shpeshta të ligjeve i bëjnë ato komplekse dhe vështirë të zbatueshme

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 TETOR - Lëvizja FOL ka mbajtur të premtën diskutimin online, me ç'rast ka publikuar reportin "Kur ligjet bëhen komplekse dhe vështirë të zbatueshme", i cili paraqet procesin e zbatimit të ligjeve në fuqi dhe ofron të dhëna për rëndësinë e legjislacionit të thjeshtuar dhe konsolidimin e teksteve të ligjeve.

Qëllimi i këtij rapporti është t'i identifikojë shkaqet e ndryshimeve dhe plotësimet e shpeshta që ndodhin në ligje. Mexhidi Demolli-Nimani nga FOL ka thënë se kjo analizë fokusohet në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe legjislacionit për të parë se ku po ndodh shkëputja e hallkës në mes të politikës dhe legjislacionit të cilat po shpijnë në ndryshime të shpeshta.

Jeton Oruci, autor i rapportit, ka pohuar se sistemi ynë është mjaft kompleks dhe se ndryshimet e shpeshta të ligjeve krijojnë pasiguri dhe paqartësi të qytetarët, bizneset dhe zyrtarët publike të administratës shtetërore të nivitet qendor dhe lokal, por sigurisht edhe te gjyqtarët e prokurorët. Sipas tij, ndryshimi i shpeshtë i ligjeve ndodh për shkak të ndryshimet të rrethanave juridike dhe institucionale dhe për shkak se ligji bazë është ndryshuar në rrethana të përshpejtura për të zënë afatet ligjore, apo kur nuk është kryer ndonjë analizë e mirëfilltë për çështjet që trajtohen në ligj. "E kuptojmë që



nuk është obligim ligjor që të gjitha aktet të publikohen në Gazeten Zyrtare, mirépo nuk është ndonjë pengesë ligjore që të publikohen ato, ngaqë palët, bizneset dhe qytetarët e tjerë duhet ta dinë ku t'i gjejnë ligjet", ka deklaruar Oruci, duke shtuar se në Kosovë gjithsej janë miratuar 480 ligje dhe mbi 85 amendamente të ligjeve që nga viti 2000. Ardi Bajraktari, drejtor i Departamentit Ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, ka thënë se çështja e konsolidimit të legjislacionit është një çështje që duhet të adresohet. "Ne kemi një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirëfillta me komisionin për legjislacion,

pavarësisht prej ndryshimit të legjislaturave", është shprehur Bajraktari. Sipas tij, rekomandimet e dhëna në këtë raport është mirë që sa më parë të adresohen. Agim Maliqi, gjyqtar në Gjykatën Supreme, ka theksuar se ndryshimet që kanë ndodhur në Ligjin për Këshillin Gjyqësor kanë ndodhur si pasojë e rikonstruktimit të KGJK-së dhe KPK-së. "Problemi i ndryshimit të shpeshtë të ligjeve krijon pasiguri juridike te qytetarët dhe te zyrtarët, njëkohësisht është edhe aspekti tjetër ku thuhet se ligjet korrigohen duke u aplikuar ato, dhe shpeshherë duke e praktikuar një lig ose nen e shohim

problematikën në zbatimin e tij", ka thënë Maliqi.

Gëzim Shala, hulumtues i lartë në IKD, ka pohuar se kemi një ndryshim enorm të ligjeve pothuajse në të gjitha sferat dhe është praktikisht problematike se në një rast të caktuar të gjendet se cila është norma pozitive dhe cila normë duhet të zbatohet. "Ndryshimi i madh i ligjeve dhe rregulloreve e bën pothuajse të pamundur një person laik te ketë qasje në drejtësi. Ka raste kur vetë gjyqtarët kanë pasur probleme për ta qartësuar një situatë dhe, për më tepër, ndryshimi i shpeshtë i ligjeve po obligon edhe ndryshimin e legjislacionit sekondar", është shprehur

Shala. Sipas tij, aspekti i ligjit më të favorshëm krijon jashtëzakonisht shumë probleme dhe ideja ne këtë rast është që duhet të kemi konsolidim të ligjeve në mënyrë që të ndryshojë logjika e zbatimit të ligjeve.

Lulzim Beqiri, drejtor i Departamentit të Integrimeve Evropiane në Ministrinë e Drejtësisë, ka thënë se Ministria e Drejtësisë është një ndër ministritë e vetme në rajon që deri më tanë nuk ka pasur ndonjë njësi të veçantë për politika dhe analiza dhe si rrjedhojë, asnjë politike që është hartuar nuk është bazuar edhe aq shumë në të dhëna statistikore dhe analitike.

Kërkohet koordinim në luftën kundër krimit të organizuar



PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të premtën është mbajtur takimi i grupit punues për zbatimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit Kundër Krimit të Organizuar 2018-2022. Koordinatori i Strategjisë, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Agron Bacaj, ka theksuar se lufta kundër krimit të organizuar mbetet një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në veçanti. Ai ka thënë se institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për t'i luftuar të gjitha format e krimit të organizuar.

Anëtarët e grupit punues, përfaqësues të institucioneve të ndryshme, të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar,

kanë raportuar për aktivitetet, rezultatet, sfidat dhe sukseset e deritanishme në fushën e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Krimit të Organizuar.

Ishte vlerësim i përbashkët, se me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar, është i rëndësishëm bashkëpunimi midis institucioneve përgjegjëse për parandalim dhe luftim të kësaj dukurie.

Në këtë takim u tha se bashkëpunimi ndërinstitucional midis institucioneve është kusht për një punë më efikase për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, sidomos në procesin e shkëmbimit të informatave, të përvojave si dhe të veprimeve apo operacioneve të përbashkëta.



LIRIMI NGA TVSh-ja PËR T'I MBROJTUR VENDET E PUNËS

Prishtinë, 30 tetor - Për ta vazhduar afarizmin dhe për të mos mbyllur vendet ekzistuese të punës, një nga masat që do ta ndihmonte kompaninë prodhuese "Laberion" është lirimi nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për blerje të produkteve dhe shërbimeve vendore.

Pavarësisht prej të lehtësimit të masave në muajin qershor përfremin e përhapjes së sëmundjes Covid-19, bizneset në Kosovë po vazhdojnë të kenë humbje të mëdha. Industria e prodhimit ka zvogëluar kapacitetet prodhuese për shkak të rënies së fuqisë blerëse.

Bashkim Osmani, pronar i kompanisë "Laberion", e cila merret me prodhimin e lëngjeve në Kosovë, thotë se lirimi nga TVSh-ja për blerje të produkteve vendore do të ndikonte në rritjen e konsumit dhe në mbajtjen e vendeve të punës. "Kjo masë do të na ndihmonte shumë. Këtë masë po e marrin edhe shtetet e tjera të rajonit. Për shkak të pasqyrave jo të mira të afarizmit në këtë kohë të pandemisë, ne kemi menduar që për t'i mbajtur këto vende të

punës, na ishte dashur një masë e tillë pasi që nga kjo do të përfitonim ne, por edhe qytetari, pasi që do të blinte produkte me çmime më të lira", thotë Osmani për "Radion Evropa e Lire".

Panxha: Lirimi nga TVSh-ja rrít fuqinë blerëse

Lirimin nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për blerje të produkteve dhe shërbimeve vendore e ka këruar Klubi i Prodhuesve në Kosovë. Astrt Panxha nga kjo organizatë, e cila përfaqëson një numër të madh të bizneseve prodhuese, thotë se lirimi nga TVSh-ja do të ndikonte në rritje të konsumit të produkteve vendore. "TVSh-ja është një tatim që nëse hiqet e bën dallimin se cilin produkt e blenë qytetari. Produkti që nuk ka TVSh, gjithmonë konsumatori tenton ta blejë. Në mënyrë që të mos ulin numrin e të punësuarve, prodhuesve iu nevojiten masa shtesë që do të ndikonin në përmirësimin e pozicionit të tyre. Kosova më shumë se kurrë ka nevojë përrritje të prodhimit", thotë Panxha.

Kërkesa për lirim nga TVSh-ja, shtron Panxha, u është dërguar autoritateteve kompetente dhe pritet të merret ndonjë vendim. "Në këtë javë do të takohemi edhe me kryeministrin e Kosovës dhe shpresojmë që të hasim në mirëkuptim, të pranohet kjo kërkësë dhe të aplikohet", thotë Panxha.

Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike nuk parasheh lirimin nga TVSh-ja

Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili ka kaluar në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës, ka paraparë plotësim-ndryshimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, por nuk ka paraparë lirimin nga TVSh-ja për blerjen e produkteve dhe shërbimeve vendore. Plotësim-ndryshimi parasheh vetëm futjen në normë të reduktuar të TVSh-së, furnizimet e hoteleve, restoranteve dhe shërbimet e ushqimit. Sipas Ligjit për TVSh-në, ministri i Financave mund të nxjerrë akt nënligjor për

zgjerimin ose reduktimin e listës së produkteve me normë të reduktuar.

"Radio Evropa e Lire" ka provuar të marrë përgjigje nga Ministria e Financave lidhur me kërkesën e prodhuesve përlirim nga TVSh-ja, por deri më tanë kjo ministri nuk ka kthyer përgjigje.

TVSh-ja në Kosovë ka dy norma

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar është tatim që i ngarkohet konsumatorit në mallra dhe shërbime. Në Kosovë TVSh-ja zbatohet që nga viti 2001. Deri në vitin 2015 TVSh-ja ka qenë 16 për qind, ndërsa nga viti 2015 në Kosovë janë të përcaktuara dy norma të TVSh-së: norma standarde 18 për qind dhe norma e reduktuar 8 për qind. Disa nga shërbimet dhe mallrat që tatohen me 8 për qind në Kosovë janë faturat e shpenzuara të ujtit, ato të energjisë elektrike dhe të ngrohjes, pastaj prodhimet nga drithërat dhe qumështi, vajrat përgatim e të tjera. Për produktet ose shërbimet e tjera, TVSh-ja është 18 për qind.

Heqja e TVSh-së prek sistemin fiskal

Për ta bërë lirimin nga TVSh-ja për blerje të produkteve dhe të shërbimeve vendore, kërkohen procedura, thotë ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri. Ai kujton që TVSh-ja është e rregulluar me ligj dhe duhet bërë ndryshimi i ligjit. Shatri shtron se ligji mund të ndryshohet, por heqja e TVSh-së nuk është një praktikë e mirë që duhet bërë, pasi që mund të rezikohen të hyrat për buxhetin e shtetit. "Unë nuk do ta rekomandoja këtë, pasi rezikohet qëndrueshmëria buxhetore dhe

stabiliteti fiskal i vendit. Edhe ashtu të hyrat në buxhetin e shtetit kanë rënë. Ekonomia e Kosovës është e brishtë dhe mund të vijmë deri te një kolaps buxhetor", thotë Shatri. Gjatë periudhës janar-korrik 2020, të hyrat totale buxhetore kanë shënuar një rënje prej më shumë se 11 për qind apo rrëth 120 milionë euro më pak krahuan me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo normë e rënies, sipas zyrtarëve të Ministrisë së Financave, pritet ta karakterizojë fundin e vitit 2020, me rrëth 300 milionë euro më pak të hyra.

Banka Botërore: Pandemia po kërcënon vendet e punës

Raportit i Rregullt Ekonomik i Bankës Botërore, publikuar më 22 tetor, ka vënë në pah se pandemia Covid-19 po kërcënon vendet e punës në Kosovë. Sipas këtij raporti, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret me 8.8 për qind në vitin 2020. Oda e Afarizmit e Kosovës dhe Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat po ashtu flasin për një numër të madh të punëtorëve, të cilët kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Sipas këtyre dy mekanizmave, deri në fund të vitit 2020 parashihet të humbin punën deri në 100 mijë të punësuar. Bizneset në Kosovë, për t'i mbajtur punëtorët në punë dhe për t'i rikuperuar humbjet nga pandemia Covid-19, janë ndihmuar nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike i Qeverisë së Kosovës.

Për këto biznese, nga ky Fond i cili kap vlerën e mbi 350 milionë eurove, janë ndarë së fundmi 60 milionë euro përbiznese, por këto mjete janë vlerësuar të pamjaftueshme nga vetë bizneset.

Qeveria miratoi Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2021



Buxheti për vitin 2021 planifikon të hyra sipas parashikimeve fiskale në shumën prej 1 miliard e 885.9 milionë eurosh, që janë 97.4 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 parashikohet të jenë 2 miliardë e 412.6 milionë euro, apo 207.6 milionë euro më të vogla se në vitin paraprak

EPOKA
E RE Albulena S. MAVRAJ

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 TETOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të premtën mbledhjen e rregullt, në të cilën ka miratuar projektligje dhe vendime të ndryshme të fushave të përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore. Në këtë mbledhje është miratuar Projektligi mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, i cili do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës për shavrtim dhe miratim.

Buxheti për vitin 2021 planifikon të hyra sipas parashikimeve fiskale në shumën prej 1 miliard e 885.9 milion eurosh, që janë 97.4 milionë euro më shumë sesa në vitin e kaluar. Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 parashikohet të jenë 2 miliardë e 412.6 milionë euro, apo 207.6 milionë euro më të vogla sesa në vitin paraprak.

Përgatitjen dhe harmonizimin e kërkesave të organizatave buxhetore për Buxhetin 2021 e ka përcjellë situata e rënduar me pandeminë Covid-19, por edhe projeksionet e të hyrave dhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore. Kjo situatë e ka bërë të vështirë edhe parashikimin e zhvillimeve si dhe një deficit në vlerë prej 4.2 përqindësh të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), i cili do të përmbushet me emetimin e

lettrave me vlerë nga Thesari i Republikës së Kosovës dhe nga financimet e jashtme.

financimet e jashtme. Projektbuxheti, në përputhje me ligjin, të premten është proceduar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim. Qeveria ka miratuar edhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Me miratimin e kësaj marrëveshjeje,

Ministrimi e Kosovës i ka miratuar një marrëveshje me Shqipëri, që do të përfitojë 90 milionë euro në formë të mbështetjes së projekteve zhvillimore në fusha të ndryshme. Edhe Projektligi përmasat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve të shpejtësisë së lartë, që do të përfitojë 200 milionë euro.

Ky projektligj lehteson dhe nxite ndertimin e rrjeteve te komunikimit me shpejtesi te lartet dhe promovon peredorimin e pérbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese, duke mundësuar një zhvillim më efikas të infrastrukturës së re fizike, në mënyrë që këto rrjete të mund të

shtrihen me kosto sa më të ulët. Projektligji përcakton të drejtat dhe obligimet minimale për ta lehtësuar shtrirjen e këtyre rrjeteve si dhe është në përputhje edhe me Direktivën e Parlamentit Evropian për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësish së lartë

Miratimin nga qeveria e ka marrë edhe vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legislativ për vitin 2020, sipas të cilit, Projektligji për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues ndahet në dy projektligje, si dhe shtyhen afatet e miratimit të 19 projektligjeve nga Qeveria e Kosovës. Me këtë vendim, në Programin Legislativ për vitin 2020 shtohen 15 projektligje të reja, ndërsa hiqet nga Programi Legislativ për vitin 2020 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Teatrot në Kosovë.

Po në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar është themeluar komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave në procesin e rekrutimit të katër anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, në këtë përbërje: Ibër Alaj, u. d. sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues; Razafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Pushtetit Lokal, anëtare;

Besim Kamberaj, u. d. sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, anëtar. Qeveria ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për bartjen e mjeteve financiare në shumën prej 860 mijë e 190 eurosh te komunat e Kosovës. Këto mjete do të përdoren për ekzekutimin e

shtesave në pagë për zjarrfikësit. Po ashtu, qeveria ka miratuar edhe kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për transfer të mjeteve nga shpenzimet kapitale te kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime në shumën prej 138 mijë e 940 eurosh. Këto mjete do të përdoren për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Mitrovicën e Veriut.

Vieriut. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe vendimin për ndalim të të gjitha shtesave për zyrtarët në organizata buxhetore, që janë në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitet. Shtesat që nuk janë në kundërshtim me nenin 80 të këtij Ligji, si dhe ato që kanë bazë ligjore në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, mbeten në fuqi dhe nuk do të ndikohen nga ky vendim.

vendim. Është aprovar Raporti nëntëmujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020, i cili do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sipas Raportit, evidentohen të hyra në total 1,502,25 milionë euro, që janë 10 për qind më të vogla se në periudhën e njëjtë të viti të kaluar dhe shpenzime në total 1,512,90 milionë euro, 8 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të viti të kaluar. Bilanci bruto i fondeve në

buxhetin e konsoliduar më 30 shtator ishte 446.16 milionë euro, kurse më 1 janar 2020 ishte 458.25 milionë euro.

Me qëllim të përmbushjes së kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjat, për vitin 2020, janë ndarë mjete financiare në shumën prej 20 mijë e 721 eurosh.

20 mijë e 721 eurosh. Është aprovuar nga qeveria edhe ndryshimi dhe plotësimi i Planit Strategjik 2019-2021 për rezervat shtetërore të mallrave. Me këtë ndryshim-plotësim sigurohet dhe garantonhet për tre vjetët e ardhshëm furnizimi me produktet e nevojshme të rezervës shtetërore, të parapara me Ligjin për Rezervat Shtetërore të Mallrave. Gjithashtu, ndryshimet dhe plotësimet janë hartuar për t'u përshtatur me kërkesat pas situatës së krijuar nga pandemja Covid-19.

Përvoja e kaluar ka treguar se në listën e produkteve strategjike duhet të shtohen edhe produkta të natyrës hijgjenike, shëndetësore dhe të veshës.

dhe të ujtit të pijshëm. Qeveria ka miratuar vendimin për shtesat mujore mbi pagën bazë për personelin e institucioneve shëndetësore publike, sipas kategorive: Kategoria I - Mjekët 250 euro në muaj; Kategoria II - Infermierët 150 euro në muaj; dhe Kategoria III - Stafi teknik 100 euro në muaj.

Mustafa vizitoi fermerët e Ferizajt

FERIZAJ, 30 TETOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, ka zhvilluar vizitë pune në Komunën e Ferizajt, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Agim Aliu. Ministri Mustafa është njoftear nga kryetari Aliu për situatën në komunë, duke venduar theksin në sektorin e

bujqësisë. Ministri i MBPZhR-së ka thënë se përmirësimi i kushteve përfermerët e Ferizajt dhe atyre të tjerë Kosovës mbetet fokus i tij si ministër. Gjithashtu, gjatë vizitës ka takuar fermerë të zonës, blegtorë, gjedhтарë, përpunues të qumëshit dhe të frutave të imëta nga të cilët së afërmi eshtë informuar mbi

situatën e tyre. Ai i ka njoftuar fermerët se Ministria e Bujqësisë ka vendosur t'i paguajë dy herë subvencionet, që fermerët sa më lehtë ta përballojnë situatën e shkaktuar nga Covid-19.

Pos kësaj, ministri Mustafa ka thënë që ai dhe ekipi i tij pandërprerë kanë punuar që shpërndaria e subvencioneve

të bëhet si duhet. Në këtë aspekt tha se sistemi i evaluimit për grante dhe subvencione është përditësuar deri aty sa gjasat për të manipuluar janë të barabarta me zero. "Kemi punuar ditë e natë që të arrijmë deri në këtë sistem i cili ka krijuar një fushë me kushte të barabarta për secilin fermer", u shpreh Mustafa.



Kosova t'i rrisë investimet në sektorin kibernetik dhe mbrojtjen e të dhënave



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 TETOR - Rreziqet kibernetike ndikojnë në mundësitë për të operuar, në reputacion, madje edhe në ekzistencën e bizneseve. Sektori privat duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë hartimit dhe përmbushjes së praktikave për siguri kibernetike, ruajtjes së të dhënave të klienteve, pronës intelektuale, si dhe infrastrukturës kritike. Këto, ndër të tjera, u thanë në punëtorinë e organizuar nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në të cilën u diskutua përmbrrojtjen e të dhënave, për shitësit e besueshëm, për sigurinë kibernetike dhe për privatësinë e informacionit.

Valerie Tucker, zyrtare për ekonomi në Ambasadën e ShBA-së në Kosovë, njëherësh edhe moderator e punëtorisë, tha se me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit për Rrjetin 5G në

mes të Kosovës dhe ShBA-së, Kosova ka marrë një hap shumë të rëndësishëm drejt ruajtjes së sigurisë kombëtare, të drejtave të njeriut, pronës intelektuale dhe të dhënave personale, sot dhe në të ardhmen. Agim Bekaj, përfaqësues i Kosovës në kompaninë amerikane "Microsoft", ka potencuar se në aspektin kibernetik njëri nga problemet më të mëdha në vend është shkalla e lartë e piraterisë si dhe përdorimi i softuerëve të jashtëligjshëm. Sipas tij, "Microsoft", duke përcjellë transformimin digital të proceseve arsimore, i është përkushtuar mbrojtjes së fëmijëve dhe të dhënave të tyre duke ofruar një platformë të sigurt dhe pa pagesë përvijimin e mësimive. Më tutje, ai ka theksuar se një ndër mënyrat më efikase për t'i shprehur sulmet kibernetike janë investimi në mbrojtjen e identitetit dhe të dhënave, ndërsa u ka bërë thirrje bizneseve për t'i shfrytëzuar shërbimet cloud.

Andrej Petreski, përfaqësues i kompanisë "Cisco", ka thënë se pandemia Covid-19 në mënyrë të theksuar ka vënë në pah rëndësinë e sektorit të teknologjisë dhe informacionit brenda bizneseve, prandaj avancimi i të njëjtës është i domosdoshëm. Sipas Petreskit, megjithëse kompanitë e mëdha janë rëndomë të vetëdijshme mbi rëndësinë e mbrojtjes kibernetike, kompanitë e vogla, të cilat janë më të rrezikuarat nga sulmet kibernetike, kanë nevojë për investime në sisteme mbrojtëse dhe qendra të dhënave.

Ashken Adili, zyrtar i informacionit në kompaninë "Cactus", tha se ndër hapat e para që duhet të merren mbi mbrojtjen nga sulmet e ndryshme kibernetike janë investimi në shitësit e besuar, krijimi i sistemave mbrojtëse të informatave si dhe mirëmbajtja e tyre gjatë tërë kohës. Adili, gjithashtu, potencoi se si shtet i

ri, Kosova është subjekt i rreziqeve kibernetike, ndërsa ekziston nevoja për investim në edukimin mbi mbrojtjen e të dhënave, sidomos te të rinjtë. Tanzer Abazi, themelues dhe menaxher i përgjithshëm i kompanisë "FindBug", theksoi se në Kosovë ekziston mungesë e theksuar e dijes rrëth menaxhimit të dhënave si dhe mbrojtjes së rrjeteve të kompanive, çështje këto rrëth të cilave "FindBug" ka pranuar kërkësë për ndihmë nga sektori të ndryshëm. Abazi potencoi nevojën për investim më të madh nga shteti në sektorin kibernetik dhe sigurimin e privatësisë së dhënave. Drinor Selmanaj, kryeshef ekzekutiv i "Cyber Academy", theksoi se digitalizimi i nxitor ngaj shpërthimi i pandemisë ka krijuar mundësi për sulme kibernetike dhe si rrjedhojë kompanitë janë motivuar të investojnë në këtë drejtim. Duke iu referuar avancimeve në

sektorin global të kibernetikës, ai përmendi edhe avancimin e sulmeve ndaj infrastrukturave kritike të kryera edhe ndaj shteteve më të zhvilluara, me ç'rast theksoi se është e domosdoshme të krijojen strukturat e duhura mbrojtëse për Kosovën. Robert Shala, kryeshef ekzekutiv i kompanisë "Sentry", ka potencuar se mungesa e një tregu të sigurimeve për rreziqet kibernetike është një barrierë tjetër e zhvillimit të këtij sektori. Sipas tij, ekzistimi i të njëjtë do të mund të ndihmonte në zhvillimin e bizneseve, duke stimular avancimin e sistemeve të mbrojtjes së dhënave të tyre. Shala tha se sa iu përket infrastrukturave kritike, ekzistojnë disa boshllëqe brenda fushës telekomunikuese që duhet adresuar, derisa theksoi se duhet të sigurohet besueshmëria e shitësve të shërbimeve kibernetike, meqë kjo infrastrukturë shërben për të dhëna në nivel nacional.

Krasniqi: Jemi të përkushtuar që ta rrisim përkrahjen për bizneset

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka vizituar kompaninë "Agribau" në Prishtinë, e cila importon makineri të markave të ndryshme, kryesisht makineri të bujqësisë. Ministri Krasniqi fillimisht i ka njoftuar drejtuesit e kësaj kompanie për obligimet që ka Kosova ndaj Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe se për këtë ka treguar se është nxjerrë Udhëzimi Administrativ 02/2020 për makineritë, ku parashihet që bizneset tona obligohen t'i plotësojnë disa standarde në kuadër të shenjës së konfirmitetit gjatë tregtimit.

"Arsyeja kryesore e kësaj vizite të përbashkët është që të konstatojmë nga afër se këto makineri, të cilat importohen në Kosovë, iu përgjigjen të gjitha kërkesave ligjore, përkatësish i plotësojnë kërkesat themelore dhe kërkesat e standardeve të harmonizuara që janë të shoqëruara me dokumentacionin teknik (deklaratën e konformitetit dhe certifikatën e konformitetit) përvendosje në treg, njëkohësisht ofrojnë siguri gjatë përdorimit", u shpreh ministri Krasniqi. Ai ka bërë me dije se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka caktuar

inspektorë të veçantë sa i përket inspektime të makinerive, të cilët do të kërkojnë që bizneset t'i përmbushin standarde përmes deklaracioneve gjatë importit. Ministri Krasniqi ka ritheksuar edhe një herë faktin se si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë janë të përkushtuar që ta rrisin përkrahjen për bizneset të cilat operojnë në këtë sektor, për certifikimin e produkteve të tyre me skema të veçanta. "Gjithashtu, do t'i shtojmë aktivitetet e mbikëqyrjes inspekuese për të garantuar një treg me produkte të sigurta", ka thënë Krasniqi.



Lagjja e dytë në Skenderaj së shpejti do të bëhet me poligon sportiv

SKENDERAJ, 30 TETOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë me dije se të rinjtë e lagjes 2 në këtë komunë së shpejti do ta kenë poligonin sportiv. Në këtë kontekst, kjo komunë ka theksuar se nxënësit dhe të rinjtë e fshatit Rezallë tashmë e kanë një poligon për zhvillimin e aktivitetave të tyre sportive, kurse të rinjtë e Polacit do të kenë së shpejti një fushë sportive moderne.

Për ta parë nga afër zhvillimin e punimeve,

kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me nënkyryetarin Nuredin Lushtaku, drejtorin e Kulturës, Abdyl Ymeri, drejtoreshën e Urbanizmit, Saniye Ahmeti, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Fatbardha Haliti, si dhe drejtorin e Inspektoratit, Arton Veliu, kanë vizituar nga afër punimet që janë duke u bërë në poligonin sportiv të lagjes 2, projekt ky i financuar nga komuna dhe Ministria e Pushtetit Lokal, në kuadër të

"Grantit të përformancës" për vitin 2018.

Po ashtu, ata kanë vizituar edhe punimet në poligonin sportiv në fshatin Polac si dhe poligonin sportiv të shkollës filllore "Malush Ahmeti" në fshatin Rezallë, ku i pranishëm ishte dhe asamblisti Sami Aruçaj. "Me anë të këtyre poligoneve si dhe ambienteve sportive po u mundësojmë të rinje që ta kenë hapësirën adekuate për t'i ushtruar aktivitetet e tyre", ka thënë Jashari.



Nis ndërtimi i objektit të ri të QMF-së në Arbanë të Prizrenit

PRIZREN, 30 TETOR (ER) - Me rastin e fillimit të punimeve të Qendrës së re të Mjekësisë Familjare (QMF) në lagjen Arbanë, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë, Narqize Arënliu Hoxhaj, kanë vizituar të premtën hapësirën ku do të ndërtohet kjo qendër, e cila do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për t'i përballuar kërkosat e të gjithë banorëve të kësaj lagjeje për kontrollë mjekësore. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka dekluar se objekti i ri dykatësh do ta zëvendësojë atë të mëparshmin, që nuk plotëson standardet e nevojshme përfunksionim të duhur.

Duke dhënë detaje të hollësishme rrëth projektit, drejtoresha Arënliu-Hoxhaj ka theksuar se objekti i ri do



të ketë një hapësirë prej 553 metrash katrorë, ku do të jepen shërbime stomatologjike, shërbime të diagnostikës (si ultrazëri dhe EKG-ja), dhoma e vaksinimit, e inhalimit etj. Ajo ka bërë me dije se deri në përfundimin e

punimeve që parashihet të zgjasin rrëth pesë muaj, banorët e lagjes së Arbanës do të mund t'i kryejnë të gjitha shërbimet shëndetësore në qendrat e tjera të mjekësisë familjare përreth.

Të hënën bëhet deratizimi i bodrumeve të objekteve banesore në Kamenicë

KAMENICË, 30 TETOR (ER) - Komuna e Kamenicës ka njoftuar të gjithë qytetarët e Kamenicës se të hënën, më 2 nentor, me fillim nga ora 10:00, do të bëhet deratizimi i bodrumeve të objekteve

kolektive banesore. "Qëllimi i këtij deratizimi është asnjësimi i brejtësve të ndryshëm. Luten qytetarë që t'i hapin bodrumet e tyre para orës 10:00", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



Përfaqësuesit e bizneseve pajtohen që dita e diel të jetë ditë pushimi në Mitrovicë

Mitrovicë, 30 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkyryetarin Faruk Mujka, dhe drejtorin e Inspeksionit, Fidan Ademi, kanë pritur në takim përfaqësuesit e bizneseve që operojnë në qytetin e Mitrovicës. Në këtë takim është biseduar lidhur me vendimin e marrë nga Kuvendi Komunal për rikthimin e ditës së diel si ditë pune përforsim të bizneset në Mitrovicë. Fillimisht, kryetari Bahtiri ka falënderuar përfaqësuesit në fjalë përforsim të pjesëmarrjen në këtë takim, duke thënë se me vullnetin dhe kërkosat e tyre të njëpasnjëshme drejtuar komunës vitin e kaluar, është vendosur që dita e diel të jetë



ditë pushimi përforsim të bizneset në Mitrovicë.

Ai ka thënë se kjo është bërë me qëllim që të mbështeten

pronarët dhe punëtorët e angazhuar në këto biznese. "Mirëpo partitë opozitare në Kuvendin Komunal kanë

miratuar një vendim përrikthimin e ditës së diel si ditë pune përforsim të bizneset, ligjshmëria e të cilët vendim është konfirmuar edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Siç e dini edhe ju, që nga ardhja ime kryetar komune çdoherë kam mbështetur njerëzit e biznesit dhe në bashkëpunim me ju, duke i marrë parasysh kërkosat tuaja të vazhdueshme, kemi marrë vendim që Komuna e Mitrovicës të funksionojë me rregulla evropiane, ku dita e diel të jetë ditë pushimi përforsim të gjithë bizneseve, me qëllimin e vetëm që punëtorët dhe pronarët e bizneseve të kenë një ditë pushimi, ku mund të kalojnë kohën me familjet e tyre dhe

kenë një trajtim më të mirë", ka thënë Bahtiri.

Po ashtu, kryetari Bahtiri ka potencuar se mosrespektimi i këtij vendimi nga ana e tij rezulton me shkelje ligjore gjë të cilën ai nuk e dëshiron, pasi është i përkushtuar përforsim i të gjitha ligjeve të Republikës së Kosovës. Mirëpo, ai ka thënë se do të përpiqet t'u ndihmojë njerëzve të biznesit të cilët janë përforsim të diel të jetë prapë ditë pushimi.

Ndërsa përfaqësuesit e bizneseve të pranishëm në takim kanë qenë të pajtimit që dita e diel të jetë ditë pushimi përforsim të bizneset në Mitrovicë, në mënyrë që kjo komunë të jetë shembull dhe model përforsim e tjera përforsim i organizimin dhe funksionimin e mirë të tyre.

SHAIP KAMBERI, NJË KAMBANË E NDËRGJEGJES SË FJETUR

Çdo diplomat dhe gazetar i huaj që e ka ndjekur këtë fjalin, në notesin e tyre sigurisht kanë shënuar përshtypjet e tyre, duke nën vizuar me laps të kuq nevojën urgjente për ta ndryshuar dioptrinë e qasjes ndaj kësaj pjese të Serbisë, ku regjimi serb me vite po ushtron një politikë sistematike të spastrimit etnik



Nga Mehmet PRISHTINA

Fjalimi i fundit i deputetit shqiptar nga Tërnocë në Parlamentin e Serbisë në Beograd, zgjoi nga letargja një pjesë të madhe të shoqërisë së fjetur, por edhe prishi stereotipin bardh e zi mbi imazhin e shqiptarëve në Serbinë e Jugut. Çdo diplomat dhe gazetar i huaj që e ka ndjekur këtë fjalin, në notesin e tyre sigurisht kanë shënuar përshtypjet e tyre, duke nën vizuar me laps të kuq nevojën urgjente për ta ndryshuar dioptrinë e qasjes ndaj kësaj pjese të Serbisë, ku regjimi serb me vite po ushtron një politikë sistematike të spastrimit etnik.

Informacionet që vijnë nga Presheva, bie fjala, thonë se kjo qytezë ka mbetur pa shtyllat kryesore të administratës shtetërore, sepse të njëjtat janë transferuar në Vrajë. Lehonat shqiptare nga kjo trevë janë të detyruara të lindin në spitalet e Vrajës dhe Nishit, kurse shumë shqiptarëve autoktonë nga Medvegja po ua grabisin adresat e tyre të vendbanimit, për arsy se projektuesit e politikës diskriminuese në Beograd kanë si synim lodhjen deri në palçë të kësaj popullate, e cila, sipas tyre, shpëtimin e vetëm mund ta gjej duke u shpërndar, ose në

Kosovë, ose në Perëndim. Shaip Kamberi me të drejtë vlerësoi se nga Serbia nuk mund të pritet që ta zgjidhë çështjen e vrasjes së vëllezërve Bytyqi, përderisa, ndër të tjera, vrasja e gazetarit (pronarit dhe kryeredaktorit të së përditshmes "Dnevni Telegraf"), Slavko Curuvija, nuk ka prosperitet pa pajtim, nuk ka pajtim pa u ballafaquar me të kaluarën", ka thënë Kamberi. Fjalimi i deputetit Kamberi ka prodhuar një entuziazëm të madh në opinionin publik, ndërkohë që jo pak zëra opozitarë në Beograd, siç është Sonja Biserko, Natasha Kandiq etj. e kanë vlerësuar me nota pozitive, duke inkurajuar atë dhe të ngjashmit që edhe në të ardhmen të mbajnë qëndrime të tillë oportune kundrejt regjimit.

Themeluesja dhe ishdrejtoresha e Qendrës për të Drejtë Humanitare, Natasha Kandiq, shkroi në llogarinë e vet në "Twitter", se për të gjitha ato që Kamberi i ka thënë në Kuvendin e Serbisë, "ne kemi nevojë sikurse për ajë". Ndërkohë që Rada Trajkoviq, politikane serbe nga Graçanica dhe kryetare e Lëvizjes Evropiane të Serbëve nga

vrrarë gjatë luftës në fund të viteve 1990, ishin varrosur në varreza masive, si dhe duke theksuar se këto ishin kryer nga "strukturat e organizuara të shitetit", të cilin ajo tani e përfaqëson. "Këto krimet luftë ishin urdhëruar dhe kryer nga zyrtarë serbë. Nuk ka prosperitet pa pajtim, nuk ka pajtim pa u ballafaquar me të kaluarën", ka thënë Kamberi. Fjalimi i deputetit Kamberi ka prodhuar një entuziazëm të madh në opinionin publik, ndërkohë që jo pak zëra opozitarë në Beograd, siç është Sonja Biserko, Natasha Kandiq etj. e kanë vlerësuar me nota pozitive, duke inkurajuar atë dhe të ngjashmit që edhe në të ardhmen të mbajnë qëndrime të tillë oportune kundrejt regjimit.

Themeluesja dhe ishdrejtoresha e Qendrës për të Drejtë Humanitare, Natasha Kandiq, shkroi në llogarinë e vet në "Twitter", se për të gjitha ato që Kamberi i ka thënë në Kuvendin e Serbisë, "ne kemi nevojë sikurse për ajë". Ndërkohë që Rada Trajkoviq, politikane serbe nga Graçanica dhe kryetare e Lëvizjes Evropiane të Serbëve nga

Kosova, e quajti Kamberin udhëheqës të ri të opozitës. "Të paktën ai në mes të Beogradit dhe para Kuvendit të Vuçiqit guxon t'ia thotë në sy regjimit. Për dallim nga Lista Serbe e cila rri në Prishtinë, hesht dhe miraton, ndërkohë që Mitrovica e zgjedh pa rezistencë", ka shkruar Trajkoviq. Përfaqësuesit e politikës zyrtare në Beograd, në krye me presidentin Vuçiq, e kanë konsideruar fjalimin e deputetit Kamberi si një favor që, sipas tyre, shteti serb ua bënë jobashkëmendimtarëve. Vuçiqi është shprehur i lumtur që shqiptarët në Serbi mund të flisnin kaq hapur për këto probleme para një audience milionëshe. "A guxojnë disa të tjerë që këtë ta thonë në Prishtinë, Tiranë apo diku tjetër? Ata ankohen se nuk morën një post ministri. Ne ua ofruam një zëvendës, por duket se kishim një vlerësim të mirë për të mos i dhënë postin ministri dikujt që flet kështu përvendin e tij", tha Vuçiqi. Por, Vuçiqi e harron një detaj jo pak të rëndësishëm. Serbët në Kosovë nuk kanë nevojë të flasin në Kuvendin e Kosovës për arsy se në vend të tyre flet vetë Vuçiqi,

Prishtinë, 30 tetor 2020

kurse Lista Serbe është zgjatim i shtetit të Serbisë në Kosovë. Dallimi në mes të pozitës së shqiptarëve në Serbinë e Jugut dhe serbëve në Kosovë është si nata me ditën dhe këtë qëndron absurditeti i një pjese të negociatave Kosovë - Serbi ku padrejtësish Kosova po trajtohet si të ishte problem i brendshëm i Serbisë, ndërkohë që për statusin shqiptarëve në Serbi të jugut askush nuk mëritet. Këta të fundit deri më tanë nuk janë përfshi në asnjë prej pikave të këtyre negociatave dhe aq më keq kur në emr të tyre shpesh bëhet propagandë patriotike pa mbulesë në Prishtinë dhe Tiranë. Serbia e jugut përfundimisht duhet të përfshihet në hartat e kujdesit institucional jo vetëm në Beograd, por edhe në Prishtinë dhe në Tiranë. Kjo krahinë e banuar me shqiptarë nuk guxon të zbratzet siç kishte ndodhur në fund të shekullit 19-të me Sanxhakun e Nishit, por këtë proces mund ta frenoj vetëm një koordinim i mirë në mes të vet përfaqësuesve legjitimë të kësaj krahine dhe qendrave të vendosjes, si në Bruksel e Uashington, por edhe në Tiranë dhe Prishtinë.

Ferizaj dhe qyteti Cedar Falls në Iowad do ta fillojnë bashkëpunimin

FERIZAJ, 30 TETOR (ER) - Kuvendi i Komunës së Ferizajt në mbledhjen që ka mbajtur të premten ka shqyrtauar disa pikë të rëndësishme dhe janë marrë vendime për to. Para dy muajsh ky kuvend pati marrë një vendim që i liron nga pagesa e tatimit në pronë banorët e Ferizajt që duan t'i registrojnë veturat e tyre, por nga Ministria e Financave është kërkuar anulimi i këtij vendimi.

Drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, ka thënë se ky vendim duhet të anulohet për arsy se në bazë të ligjit në fuqi, niveli lokal nuk ka të drejtë

të marrë vendime për heqje të kushtëzimeve, pas kërkesës së ministrisë përkatëse që ka kërkuar anulimin e këtij vendimi në seancën e Kuvendit.

Ndërkohë që mesin e këshilltarëve komunalë nga pozita dhe opozita pati mendime të ndryshme rrëth kërkesës për anulimin e këtij vendimi.

Këshilltarët opozitarë u anuan se është e padrejtë që Ferizajt i kërkohet anulimi i këtij vendimi derisa Prishtinës i është lejuar një gjë e tillë, kurse ata nga radhët e pozitës pohuan se

vendimet e nivelit qendror duhet të respektohen dhe janë obliguese. Gjatë punimeve të Kuvendit të Komunës së Ferizajt me shumicë votash u miratua propozimvendimi për miratimin e nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të qytetit të Ferizajt dhe Cedar Falls (IOWA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës). Po kështu, u miratua edhe raporti financiar janar-shtator 2020. Drejtoresha e Financave me këtë rast shpjegoi se gjatë kësaj periudhe janë inkasuar gjithsej të hyra vetjake 2,608,184.89 euro e cila vlerë, po të krahasohet me periudhën e vitit të kaluar, ka një rënje prej 39.8 përqindësh, ndërsa krahasuar me planin janë realizuar 52 për qind, duke vlerësuar edhe gjendjen që ka shkaktuar pandemia në ekonomitë familjare dhe ato biznesore.



vendimet e nivelit qendror duhet të respektohen dhe janë obliguese. Gjatë punimeve të Kuvendit të

Komunës së Ferizajt me shumicë votash u miratua propozimvendimi për miratimin e nismës për bashkëpunim

Filluan punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Bitesh të Gjakovës

Gjakovë, 30 tetor (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka uruar banorët e fshatit Bitesh për fillimin e

punimeve për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në këtë fshat. Me ketë rast, Gjini ka thënë se ky fshat ka qenë pothuajse i harruar.

"Është një premtim që e kam dhënë para tri vjetëve. Me ndërtimin e këtyre rrugëve, mirëqenia e banorëve të kësaj ase do të

jetë më e mirë dhe ata do të kenë një qasje të duhur në infrastrukturën rrugore", është shprehur kryetari Gjini.



“Hajrija”, tragjedia e papërfunduar e Gjergj Fishtës

Vepra e fundit e Atë Fishtës që u vu në skenë para se ai të shpalaje i ndaluar ishte "Juda Makabé" me regji të Zef Zorbës, në përvjetorin e XXXIII-të të pavarësisë. Ajo u dha në teatër për tre ditë deri kur, me urdhër direkt nga Mehmet Shehu, gjithçka u ndalua. Si për ironi të fatit, dekada më vonë, kur tanimë figura e Atë Gjergj Fishtës po konsolidonte vendin që i takonte në letërsinë shqipe, po Zef Zorba merr pjesë me një kumtesë në një ndër konferencat e para që mbahen për fratin e madh. Ajo kumtesë ruhet në arkivin personal të Zef Zorbës dhe botohet për të parën herë me dëshirën e vajzave të tij, Elena dhe Luçi

Nga: Zef ZORBA
Përgatiti për botim:
Andreas DUSHI

Data "7 Fruer 1939" që gjindet në dorëshkrimin e tragedisë "Hajrija" të nisur së shkruari nga Fishta është vështrimplotë.
Në atë kohë, ai, edhe pse imposhtur nga sëmundja (do të vdiste pak muaj mbrapa), rreket sërisht me vazhdu prodhimtarinë letraro-artistike, edhe pse i vrarë e i zhgënjer në idealet e veta patriotike e shoqërore nga rrjedhja e asohershme e punëve në vendintonë. Ose ndoshta për virtyt të instinktit ironik të vet (çka duket se i gëzojnë poetët) po parashikonte, i tmerruar e i pezmatuar, koin e "7-të Prillit".

Sepse mabetet gjithmonë ajo që ka pasë kodifikuar Shelley: "Poëtët janë buritë që thërrasin për beteja, poëtët janë ligjvénësit anonimë të botës". Dhe ai, si katapult për të tillë sulm shkallmues, si kurdoherë në mbrojtje të drejtësisë, do të zgjidhte mjetin më efikas e të preferuem: dramatikën, art të cilin e ka pasur kështjellë të pamposhtur e ngallënqyse gjithmonë. E për shumë arsyemadie.

Së pari, dashuria e prirja që ka pasë vazhdimisht për skenën. Ai e ndjente në shpirt se prej një poditë tillë, tribunë objektivizmi estetik, mund të shpaloste pa cen subjektivizmin që i mufatej – hareshëm ose edhe kobshëm – me poliendrizmin e shpirtit të vet. Mes sypar të hapun e shifte vetvehten, jo vetëm nismëtar e flakërues idealesh e parimesh, por njëherit edhe personazh dialogues me popullin. E dëshmon këtë, jo vetëm prodhimtaria e tij e gjerë në dramatikë, por edhe thurja teatrale që ndeshet rëndom edhe në gjinitë e tjera poetike të përqafuara prej tij. Ai deri një sonet satirik “lum i forti” e ndërtón si bocet skenik me personazhet dialogues të emërtuar (jashtë metrikës) në krye të vargjeve – batutë. Së dyti, e kjo më kryesorja,

e saktë se Fishta e ka ditur mirë sa virtuozitet e afërsi mbartte në vete raporti audio – viziv me masën. Si predikator i shquar që ka qenë, e ka pasë të qartë se komunikimi shqisor është më emotiv e i frytshëm sesa raporti liberator “autor – lecites”, pavarësisht nga popullariteti që mund të gezojë faqja e shkruar. Pse në fund të fundit leximi ka më tepër tipar akademik të kufizuar, kurse spektakli është kurdoherë asociativ. Prandaj Fishta kurdo që ka ndjerë nevojën e një kuvendimi, referendar në synim, i është drejtuar skenës. Qoftë për të fishkulluar të meta e dobësi, qoftë për të dënuar pa mëshirë mendësi e komplotime të poshtra, të ishin ato edhe nga “Fuqi të Mëdha”, që mizorisht po coptonin atdheun. “Juda Makabé” i shkruar në vorbullën e Luftës Ballkanike, bëhet akuzë aq e fuqishme, saqë At Gjergj Fishta, i turitur nga

*"O Perëndi, a ndjeve?
Tradhëtarët na lanë pa atdhe
E Ti rrin e gjuen me rrfe
Lisat n'për male kot!"*

Tri janë tragjeditë e Fishtës: "Juda Makabe", "Ifgjinia" dhe "Hajrija". Kjo e fundit, mjerisht e pambaruar, i janë gjetur e botuar vetëm dy aktet e para. Dy tragjeditë e para, sikundër edhe pjesa dërrmuese e veprave të tjera skenike të tija, kanë gjëzuar mjaft herë skenat teatrale, kanë hasur aty miratim emotiv të gjithëmbarshëm, që pa frikë mund të konsiderohet kritikë popullore. S'ka pasë si të ndodhët kështu me «Hajrjen». Nga ana tjetër, «Hajrija» e Fishtës është mjaft pak e njobur edhe si lexicë, megjithëse në dy aktet e botuara, shtron e zbulon shumë veçori të spikatura estetike, si dhe mjaft për të qëmtuar mbi evolucionin poetik të autorit.

Për këtë arsy, por edhe për tiparin ultimativ të saj, duket me vend kufizimi te «Hajrija ». Do të dëshironim që këto pak fjalë të



vlenin sadopak për një këndvështrim tjetër të artit të Fishtës, qoftë ky edhe i karakterit limitativ.

Edhe pse me folë për heterogenjinë e veprave teatrale të tija, ka rrezik me shkarë në kodifikime bibliografie e komentative që shpesherë tingëllojnë pedante. Porse edhe analiza spekulative mbi një vepër të papërfunduar i ka rreziqet e veta. Veçse edhe shmangjet mund të mënjanohen, po të mos u largohemi treguesve të gjetur si dhe analogjive krahasimore. Mbase, na ndihmon këtu, ligji matematik i probabilitetit.

Mbështetje, madje edhe inkurajim, na jep kritika e përbotshme që dendur merret edhe me vepra cunge e fragmentare, të trashëgura nga lashtësia. Kushedi pse, po kur lexoj dy aktet e ‘Hajrës’, më vete mendja gjithmonë te ”Sklavi“ i papërfunduar i Mikelanxhelos, ter rropatja e tij e stërmundimshme për t'u shkoqur prej gurit që e robëron.

Vështirësia për një gjikim panoramik mbi këtë tragjedi thellohet edhe ma tej, ngase, siç duket, s'është gjetur ndonjë skenë ose stesure paraprake e thurur nga autori. Të ketë humbur ajo bashkë me të tjera gjëra të vyera gjatë bastisjeve rrënimtare të kryera në Kuvendin Françeskan? Sepse s'është e besueshme që Fishta, i ballafaquar me një temë aq të harlisur, të ketë nisur redaktimin e tragedisë në mënyrë bashkëkohore, pa pasë hartuan paraprakisht tërë zhvillimin psikologjik e skenik të veprës. Për një skemë të tillë, flasin projektimi i veprës në 5 akte, si dhe renditja në listën e vehtjeve të dramës të mjaft personazheve që nuk dalin në skenë në dy aktet e para të tragedisë.

Nga ana tjetër, tregues të tjera analogjikë, mbështetëse na hapin rrugë përmes gjykuar mbi veprën e sidomos mbi autorin vetë, qoftë edhe nëse tanë i mertisur nga një

vel trishtimi, por gjithsesi i kordinuar si gjithmonë te moduli i vet poetik.Në dy tragjeditë e tjera (sikurse te "Lahuta") protagonist i mirëfilltë pëershkues është ideja e lirisë e pavarësisë dhe personazhet të gjithë – duke ruajtur identitetin e vet – shërbejnë për ecjen zhvillimore, te "Hajrija", drama e tragjedia thelbësish subjektive është njëkohësisht e egërsisht objektive. Ajo, travajimet e veta, i flakëron dhunshëm kundër mjidiseve, shoqërisë, kundër mykurive e përcudnimeve që e ngruinjë.

S'ka dyshim që Fishta të jetë njohur me mitin e Medeas nëpërmjet veprave të Euripidit, Senekës, Kornejit e sa e sa dramaturgëve të tjerë, që janë marrë me këtë subjekt. Për të gjithë ato, burim ka qenë mitologjia greke: Medea e tradhëtuar prej burrit të vet – Jasonit, hero i Argonautëve – hakmerret duke

mbytur fémijët që ka pasë me të. Pra, pak a shumë të gjithë ato Medea kanë një bosht erotik të përcudnuar nga xhelozia. Kurse "Hajrija" e Fishtës nuk ngacmohet nga e tillë ndjenjë e sidomos s'është mitologjike. Ajo është historike, e martuar në një mjesid amoral e çnjerëzor. Autori s'na ka lënë shtjellimin psikologjik të personazhit, por mund ta imagjinojmë atëq mjaft mirë. Duke njobur personazhet e tjera femërore të Fishtës (Tringa, Ifgjenia, Motra e Avdisë, Ferina etj.), e sidomos duke i ditur bindjet e tija të mbështetuna fuqimisht në eskatologjinë theologjike, por edhe në filologjinë zakonore, na lejohet të supozojmë se "Hajrija" e Fishtës është fondamentalist humana, edhe pse e rrasur në infanticid nga pabesia e zvetëtimi, ku e kanë katandisur rrebeschët.

Ndoshta nga ndikimi i Molierit që "Tartufin" e neveritshëm e nxjerr në skenë vetëm në aktin e tretë e mbrota, edhe Fishta, Hajrjen nuk e paraqet në dy aktet e para. Por ngurrimi i Fishtës është dhimbja për personazhin, e cila do të jetë

dinjitoze e fisnike edhe në krim. E këtë tipar, ajo duhet ta konfirmojë edhe në katarsin sublimativ të vetëvrasjes (e thotë këtë edhe folklori e s'do mend që Fishta do të jetë bazue mbi këtë). Kurse infanticida mitike, Medea, mbijeton e madje vazhdon rrugën e vet erotike e kriminale.Një tjetër veçori për t'u rilevuar është raporti krejt specifik "vêlla – motër" që vërehet në literaturën tonë edhe gojore e që shpesh e kemi takuar të gjithë në mesin tonë deri në ditët e sotme. Antigona e Sofokliut ngre krye kundër tiranisë e diktaturës edhe me vetëflijim, kurse Hajrija shkon më tutje, shumë më tutje. Pastaj, gjuhëtarë të shqar na mësojnë, se ndërsa në gjuhët e tjera indoeuropiane nga rrënja sankriste "ma" kanë ardhur termat: motër, matter, mat, madher, në shqipe termi është tjetërsuar në substantivizëm "motër". Kjo mund të ketë ndodhur nga zhvillimet demografike e klanore, por mbasë s'është guxim të menduarit që në kodin gjenetik të femrës shqiptare të jetë i tiparizuar ky dualizëm raportativ : nënë – motër". Si rrjedhojë, mund të afirmohet se Hajrises i kanë tradhëtuar e vrarë vëllezër e bij, njëheri.E prej kësaj, s'është i vështirë dallimi me zemrën e brengosur të poetit, kërkimi i një shtegu për të përligjur, në mos etnikisht, protagonisten fatzë e për t'ia drejtuar rrufetë e veta çmoralizuesve të kombit.E këtë na e pasqyron ma së miri me ravijëzimet e mjedisit amoral dhe të personazheve kriminelë e çnerëzorë të dy akteve të para, përgjegjës këto për tragedinë e Hajrises e të kombit të robnuar e të nëpërkëmbur.Mos ai t'i ketë parë ata prapë të ngrysyrë e gjithnjë të thëngjillousra dhe pas njëzet e shtatë vjetësh pavarësie aq fort të dihatur dikur?

E u rrek t'i gjuante me rrfe!

Shkodër, më 1.10.1991

Adem Demaçi në kujtimet e mia



Nga Sulejman
E. SULEJMANI

Me Adem Demaçin jemi "njohnur" në rrrethana të jashtëzakonshme për të dytë. Ishin rrrethana të jashtëzakonshme sepse ai ishte në burgun e Prishtinës, ndërsa unë si fëmijë i shkollës filllore bash ndjeja me të dhe shokët e tij. Unë nuk i ndjeja dhimbjet e tyre fizike, por edhe dhimbjet e tyre shpirt norë i përfjetojat thellë. Kur është burgos Adem Demaçi në vitin 1975, kam qenë nxënës i klasës së gjashtë në shkollën filllore "Skënderbeu" të Zarbincës. Mendoj se përvëç dashurisë për familjen, për shokët, për mësuesit, jeta ime si fëmijë nuk ishte me lojëra fëmijërore. Në "lojën" time gjithnjë përziheshin krimet e viti 1912, krimet e OZN-ës, maskara e Tivarit, masakra e viti 1944-45 mbi Gjilanin, lufta e Shaban Polluzhës, lufta e Desivojcës e mbi të gjitha sikur tërë familjes tonë, mbi mua rëndonte vrasja e gjyshit tonë Syë Zarbincës prej OZN-ës në vitin 1947. Ishte nji vrasje që nuk vjetrohej fare, por gjithnjë ishte e freskët, e dhimbshme dhe përvëluese... Edhe në bisedat e gjata netëve të dimrit, kur nuk përmendej fare, edhe në këngët që këndonim, edhe gjatë festave, gjithmonë ajo vrasje na rrinte mbi supe. Hija e gjyshit tonë Sylë Zarbinca sillej pafundësish në shtëpinë tonë. Me njëfarë mënyre bashkëjetonim si në legjendë - ne të gjallët me të vranin.

Burgosja e nipit tonë Ilmi Ramadani në vitin 1975, që në atë kohë ishte student i ekonomisë në Prishtinë, në familjen tonë ishte si rënia e një tërmeti që t'i merr të gjitha, me përjashtim të jetës. Për një moment çdo gjë u ba e pandreqshme dhe shumë e zymtë. Ilmi Ramadani ishte djali i motrës së babës tim - Laliferes, me të cilën familje kishim një lidhje shumë të fuqishme emocionale. Babai u mbyll në vetvete dhe ftyra i mori një ngjyrë të zezë që shprehte pikëllim të pa

përkruar. Nuk dinim asgjë konkrete për ato burgosje që ndodhnin. Vetëm e kishim të quartë që ata që e kishin vrarë Sylë Zarbincën, ata po na godisnin përsëri. Përkundër kësaj zymtësie që e kaploj familjen tonë, shpresonim se një ditë do ta lironin nipin tonë nga burgu dhe ajo ditë dëshironim që do të jetë brenda javëve ose eventualisht muaji.

Një pasdite të vonë vjeshte, babai erdhë në shtëpi edhe ma i vrenjtur. Na tregoi se kishte biseduar me mësuesin Ismet Shabani, që e kishim fqinj dhe i kishte treguar se në grupin e të burgosurve me nipin tone, si ma i vjetër ndodhej një zotëri që quhej Adem Demaçi. Mësuesi i kishte pas treguar gjithash tu se Adem Demaçi është shkrimitar dhe i dënuar edhe here tjera për çështje politike. Sipas kësaj, i kishte thanë babës se "çështja qenka serioze dhe nuk po shpëtojka prej dënimit". Ky lajm na e humbi edhe atë pak shpresë që e ruanim se Ilmu do të lirohej dhe do t'i vazhdonte studimet ku i kishte lënë. Ka mundësi që gjatë vizitave që na kishte bërë Ilmu ma herët të na ketë fol për Adem Demaçin, por për habinë tonë nuk e kishim pas

mbajt në kujtesë. Prej asaj nate, Adem Demaçi më ka përcjell gjatë tërë jetës sime të mëvonshme. Kur i dënuan pastaj, në vitin 1976 e pata lexuar artikullin e gazetës "Rilindja", ku i pari ishte emri i Adem Demaçit, ku thuhej se ishte 40 vjeçar dhe me profesion "ish student". Kjo "ish student" më pati bërrë shumë përshtypje, sepse e imagjinoja një burrë 40 vjeçar i cili ju printe djemve drejt lirisë edhe nën sqetull i mbante librat për studim. Më vonë, prej babës së Ilmiut – axhës Selk, që e kishte njohur personalisht kisha mësuar më shumë për Adem Demaçin.

Më kishte mbet gjithnjë në kujtesë se mbante syze me një dioptri shumë të fortë. Në gjimnazin "9Maj" të Kamenicës me shokët të cilët veçse e "njihnim" Adem Demaçin dhe ishim në dijeni të kauzës së tij për çështjen kombëtare, pothuajse kryefjala e bisedave tona ishte Ai. Në vitin 1978 gjatë vitit të dytë të gjimnazit, një shoqe e jona i solli dy numra të revistës "Jeta e re" ku në dy vazhdime ishte botuar romani i Adem Demaçit "Gjarpërinjtë e gjakut". Romanin e lexuam me një frymë dhe në çdo rresht të tij

mundoheshim me zbërthye ndonjë të fshehtë që e kishte lënë të nënkuptohej.

Për së afërm, Adem Demaçin e kam takuar për herë të parë në vitin 1995, në shtëpinë e Sadik Zenelit në Heilbronn të Gjermanisë, ku ishin tubuar disa bashkatdhetarë për t'a dëgjuar fjalën e tij. I vogël me trup, me syzet e tij karakteristike që i mbaja mend nga biseda me axhën Selk dhe i rrëmbyeshëm në bisedë. Edhe një here tjetër e kam parë në një tubim me bashkatdhetarë në vitet e '90 diku afér Shtutgartit. Me atë rast u shpërndau edhe romani i tij "Mohimi i vetëmohimit". Ajo që më la mbresa ishte se atë ditë ai siç dukej ishte me grip dhe porsa u ul në panel, nxori nga xhepi ilaçet dhe i piu, dhe si për çudi ose nga mendimet e mia naive më erdhë me veti mendimi "Si ka mundësi që një Kolos, siç është Adem Demaçi, po e nxëjka gripi!".


Me Adem Demaçin më së shumti "kam biseduar" dhe "e kam njohur nga afér" përmes romanit e tij autobiografik "Dashuria kuantike e filanit". Një prurje e mirë e gjendjes së përgjithshme në Prishtinë dhe në Kosovë e atmosferës mytësë të pas LDB. Me ata

Çetnikë të konvertuar në partizanë, me ato kontrollë makabre shtëpi më shtëpi, e mbi të gjitha ato krismat kur i bënин shqiptarët batare tek Togbashqja. Një përkruar mbreslënës është edhe përkrimi i Profesorëve të Gjimnazit të Prishtinës, ku në kujtesë do të mbetet mësuesja e tij Vezirja në shkollën filllore gjatë LDB. Në këtë vepër, lexuesi do të mësoj për hetuesin, për qelinë dhe për dilemat e një shkrimtarë të ri brenda mureve të qelisë...

Adem Demaçi nuk është më në mesin e të gjallëve. Ai prehet di kund në varret e Prishtinës... Edhe nëse harrohet figura e tij, Ai edhe njëqind vjet me radhë do të jetoj nëpërmes veprave që na la amanet, e posaçërisht nëpërmes dy prej romaneve të tij "Gjarpërinjtë e gjakut" dhe "Dashuria kuantike e filanit". Nuk do të ketë studiues të letërsisë shqipe në Kosovë dhe historian që nuk do të merret me ato dy romane, si dëshmi e një kohe të dhimbshme dhe krenare...

Ndërsa, unë do të vazhdoj ta kujtoj Adem Demaçin si "ish student" që pret sa të dal pranvera me i vazhduar studimet aty ku i ka ndërprerë – për letërsi botërore...





RIKTHEMË PAS NJË MUAJI

Përparim Islami është duke punuar maksimalisht që të jetë në dispozicion të trajnerit pas një muaji. "Pas lëndimin të rënd që kam pësuar, kam filluar ta marrë vetën dalëngadalë. Kam filluar stërvitjet dhe po besoj shumë se mund të rikthehem pas një muaji. Gjenda është stabile dhe kjo me bën optimist për një rikthim të shpejtë", ka thënë Islami për "Epokën e re"

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 30 tetor - Mbrojtësi Përparim Islami në qershori kishte pësuar një lëndim të rënd në ndeshjen gjysmëfinale të Kupës me Feronikelit dhe Ballkanit. Islami ka thënë të premten për gazetë se është duke punuar maksimalisht që të rikthehet sa me shpejtë që është e mundur. Mbrojtësi i krahut planifikon që të jetë në dispozicion të trajnerit Klodian

Duro pas një muaji. "Pas lëndimin të rënd që kam pësuar, kam filluar ta marrë vetën dalëngadalë. Kam filluar stërvitjet dhe po besoj shumë se mund të rikthehem pas një muaji. Gjenda është stabile dhe kjo me bën optimist për një rikthim të shpejtë", ka thënë Islami për "Epokën e re". Mbrojtësi në fjalë ka falënderuar drejtuesit e klubit nga Drenasi për mbështetjen që i kanë dhënë në këtë kohë të vështirë. "Klubi me ka



qëndruar shumë afér gjatë gjithë kohës për çka jam shumë falënderues ndaj tyre. Do të mundohem që me paraqitje të mira dhe pakursyer asgjë si gjithmonë të shpaguaj gjithë atë që kanë bërë përmirësuar", ka shuar ai. Në fund, ish-mbrojtësi i Trepçës '89 ka thënë se ka arritur marrëveshje me Feronikelin përmirësuar bashkëpunimin edhe përmirësuar shumë ndryshime, por fillimi i

vite të tjera. "Gjithmonë kam pasur oferta, por Feronikeli ishte zgjedhja e parë. Kam arritur marrëveshje me kryetarin përmirësuar që përmirësuar", ka shuar ai. Në fund, ish-mbrojtësi i Trepçës '89 ka thënë se ka arritur marrëveshje me Feronikelin përmirësuar bashkëpunimin edhe përmirësuar shumë ndryshime, por fillimi i

kampionatit nuk ka qenë i prituri përmirësuar. Pas rezultateve jo të mira nga klubit është larguar trajneri Afrim Tovërlani, i cili është zëvendësuar nga Klodian Duro. Pavarësisht këtij ndryshimi rezultatet vazhdojnë të mos jenë ato më të mira, derisa ndeshje e vështirë e pret sot (e shtunë) Feronikelin ku do të takohet me Gjilanin.

NDESHJE INTERESANTE NË SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT



PRISHTINË, 30 TETOR - Java e dytë në Superligën e Kosovës në basketboll do të dhurojë ndeshje mjaft interesante. Ndesha e parë do të jetë në mes të Vëllaznimit dhe Ponte Prizrenit, dy skuadra që shpresojnë ta shënojnë fitoren

SUPERLIGA - JAVA 2

Të shtunën takohen:
 17:00 Vëllaznim - Ponte Prizreni
 19:00 Peja - Rahoveci

Të dielën takohen:
 17:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi
 19:00 Sigal Prishtina - Trepça

e parë, pasi pësuan humbje në javën e parë. Skuadra kuqezinj kishte pësuar nga Rahoveci, kurse prizrenasit nga Golden Eagle Ylli. Takim shumë interesant shihet ai në mes të Pejës dhe Rahovecit, dy skuadra që e nisën stinorin me fitore.

"Verdhezinxh" shpresojnë të fitojnë e dytë radhazi, pasi mundën Sigal Prishtinë, kurse "Vreshtarët" shënuan fitore ndaj Vëllaznimit. Përballjet në edicionin e kaluar mes këtyre dy skuadrave ishin mjaft interesante dhe kështu pritet edhe të

shtunën mbrëma. Përballje mjaft interesante vlerësohet në mes të Golden Eagle Ylli dhe Bashkimit, dy skuadra që kanë ambicione të larta dhe e filluan stinorin në Superligë me fitore, duke shpresuar se do të vazhdojnë me fitore. Takimi i fundit i kësaj xhiroje është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Trepçës. Bardhekaltrit fituan Superkupën një javë më parë, por në xhiron e parë pësuan nga Peja, ndërsa Trepça që shpëtoi përmes "play-out", pësoi humbje minimale nga Bashkimi.

GJILANI SYNON TË FITOJË EDHE NDAJ 'NIKLIT'

GJILANI, 30 TETOR (ER) - Nënkompani i Kosovës në futboll, Gjilani, serinë e rezultateve pozitive prej dy fitoreve synon ta vazhdojë edhe sot (e shtunë) në ndeshjen kundër Feronikelit. Gjilanasi pozicionohen në vendin e tretë në tabelë dhe pretendojnë të mos lejojnë shtimin e dallimit me liderin aktual, Ballkanin. Në anën tjetër, Feronikeli, pas shumë ndeshjeve, arriti fitoren ndaj Llapit dhe synim i të përzgjedhur të trajnerit

Klodian Duro do të jetë rezultati pozitiv edhe në ndeshjen e vështirë kundër Gjilanit. Befasia e këtij kampionati, Arbëria, do të përballet me Trepçën '89, kurse kryesuesit e Ballkanit në Suharekë e presin Besën e Pejës. Duke parë potencialin e klubeve dhe rezultat e gjertanishme, skuadra e Ismet Munishit është favorite, por pejanët kanë ditur të shkaktojnë mjaft befasi në këtë kampionat. Dy ndeshjet e

fundit përmirësuan humbje e dhjetë zhvillohen të dielën, kurse takohen Drenica-Prishtina dhe Llap-Drita.

SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
 13:30 Gjilani - Feronikeli
 13:30 Arbëria - Trepça '89
 13:30 Ballkani - Besa

Të dielën takohen:
 13:30 Drenica - Prishtina
 13:30 Llap - Drita



Cabanas: Luftojmë për të arritur diçka pozitive

PRISHTINË, 30 TETOR - Trajneri spanjoll Javier Cabanas ka udhëhequr stërvitjen e parë të Përfaqësueses së Kosovës. Cabanas është trajner i Besa Famgasit dhe emër shumë i respektuar në hendballin spanjoll. Ai është emëruar

kryetrajner i Kosovës për ndeshjet me Malin e Zi dhe Suedinë, në pamundësi që selektori Taip Ramadani të jetë me ekipin. Cabanas ka premtuar se të gjithë do të luftojnë për diçka pozitive në ndeshjet e vështira me Malin e Zi dhe

Suedinë. "Jam i entuziazmuar dhe i etur për ndeshjet me Malin e Zi dhe Suedinë. Kemi filluar stërvitjet, por vetëm me lojtarë të klubeve të Kosovës, pastaj vijnë lojtarët që luajnë në vendet e tjera e do të bashkohen me ne. Vetëm pasi të jemi të gjithë

mund të them diçka më shumë. Ne do të kemi rastin tonë në këto dy ndeshje dhe duhet të nxjerrim avantazhe prej kësaj. E di që janë dy ndeshje të vështira, por ne do të luftojmë për të arritur diçka pozitive", ka deklaruar Cabanas.



FFK-ja: I kemi ndihmuar financiarisht klubet e Superligës

PRISHTINË, 30 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka dalë me një sqarim për opinionin sportiv dhe më gjér. FFK-ja ka sqaruar se i ka përkrahur financiarisht klubet elitare të Superligës në mënyrë të barabartë me nga 20 mijë euro. "Federata e Futbollit e Kosovës jep sqarim për opinion lidhur me pohimet e pavërteta të disa drejtuesve të klubeve në media për, kinse, mospërkrahje financiare nga ana e federatës gjatë kohës së pandemisë Covid-19. FFK-ja është e vetëdijshme se kjo pandemi ka shkaktuar krizë të thellë në ekonominë globale dhe natyrshëm kjo ka prekur edhe ekonominë e vendit, e më këtë edhe ata që janë investitorë në klubet tona. Pikërisht për këtë arsy, FFK-ja që nga fillimi i pandemisë u ka dalë në mbështetje klubeve me fondet e saj që i ka akumuluar nga sponsorët dhe të hyrat e tjera, me qëllim që t'u lehtësohet zhvillimi i aktivitetave. Një praktikë të tillë të përkrahjes



FFK-ja e ka vazhduar edhe në edicionin e ri të garave, ku në fillim të shtatorit klubet janë ndihmuar me mjete financiare. Prandaj, drejtuesit e klubeve duhet të janë të kujdesshëm për atë çfarë deklarojnë në media dhe të mos e 'ushqejnë' opinionin me dezinformata", thuhet në njoftimin e FFK-së. "Njëherësh, të gjithë duhet ta kenë të qartë se Federata nuk mund t'ua mbulojë klubeve pagat e stafeve por, thjesht,

do të jetë e gatshme përherë të ndihmojë me aq mjete sa ka mundësi dhe për aq kohë sa nuk i rrezikohen projektet e saj. Po ashtu, rikujtojmë se klubet nuk paguajnë as koutizim, as gjyqtarët dhe nuk kanë asnjë shpenzim tjetër ndaj federatës, përveç dëniimeve që mund t'u shqiptohen për shkelje eventuale gjatë ecurisë së garave", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Messi kalon Mullerin dhe 'shënjestron' Pelen

BARCELONA, 30 TETOR - Barcelona arriti një fitore shumë të rëndësishme në transfertë kundër Juventusit, me rezultatin 0-2. Ndeshjen e vulosi i përhershmi Leo Messi në fundin e takimit, falë një penaltie të shndërruar në gol. Tashmë Messi është në vendin e katërt të golashënuarve të të gjithë kohëve. Kutojmë se 33-vjeçari ishte në të njëjtën kuotë golash me legjendën e



Gjermanisë, Gerd Müller, por tashmë Leo ka një gol më shumë se ai. Në listën e 15 golashënuarve më të mirë janë vetëm tre lojtarë që luajnë ende. Bëhet fjalë për sulmuesin e Milanit, Zlatan Ibrahimović, i cili renditet në vendin e

11 me 552 gola të shënuara në karrierën e tij. Në vendin e katërt gjemjë tashmë Leo Messin, i cili ka shënuar 721 gola. Sigurisht nuk mund të mungonte Cristiano Ronaldo që renditet në vendin e dytë me 742 gola të shënuar

Lista e golashënuarve më të mirë në histori

1. Pele	767 gola
2. Cristiano Ronaldo	742
3. Romario	734
4. Leo Messi	721
5. Gerd Müller	720
6. Ferenc Puskas	706
7. Josef Bican	636
8. Eusebio	615
9. Ferenc Deák	558
10. Artur Friedenreich	554
11. Zlatan Ibrahimović	552

Alfa Romeo rikonfirmoi kontratat me pilotët Raikkonen dhe Giovinazzi

Alfa Romeo është e kënaqur me pilotët e vet dhe ka lidhur kontrata me ta edhe për sezonin e ardhshëm. Veteranët finlandez Kimi Raikkonen dhe italiani Antonio Giovinazzi

rinovuan kontratat respektive me skuadrën aktuale edhe për sezonin dhe do të janë dyshja e pilotëve të Alfa Romeos edhe për sezonin e vitit 2021 të Formula 1. Kimi Raikkonen,

pasi nënshkroi kontraten deklaroi: "Alfa Romeo Racing ORLEN është më shumë se një ekip përmua, është si një familje e dytë. Shumë nga fytyrat që ishin rrëth meje kur

bëra debutimin tim në Formula 1 në vitin 2001 janë këtu. Atmosfera unike e kësaj skuadre më motivon që të vazhdoj në atë që do të jetë sezoni im i 19 në sport. Nuk do

të isha këtu nëse nuk do të besoja në projektin e ekipit apo nëse nuk do të ndieja atë mund të arrijmë së bashku. Ky është një ekip që vlerëson punën dhe i përshtatet stilit tim".

SHKURT

Hajrizi, MVP i xhiros së parë

KB Peja fitoi ndaj rivalit të vjetër Sigal Prishtinës 107:86, derisa kapiteni Drilon Hajrizi kontribuoi me 24 pikë, 11 kërcime dhe pesë asistime. Hajrizi ishte një nga lojtarët më të dalluar të verdhezinxje edicionin e kaluar, duke fituar Kupën e Kosovës në basketboll, kurse ka qenë edhe një nga lojtarët kyç në Përfaqësuesen e Kosovës në basketboll, në fitoret ndaj Islandës dhe Luksemburgut. Drilon Hajrizi është një nga basketbollistët më me përvojë në Kosovë, ku ka luajtur për Trepçën, Sigal Prishtinë, Bashkimin dhe Pejën apo katërshen e madhe të basketbollit të Kosovës.

Edhe një lojtar i Interit rezulton pozitiv me Covid-19

Koronavirusi duket se nuk ka ndërmend të largohet nga Interi, teksa Milan Skriniar vazhdon të jetë ende pozitiv. Pas tamponit të bërrë ditën e djeshme, është zbuluar se mbrojtësi slovak vazhdon të ketë ende virusin në trupin e tij dhe nuk mund t'u bashkohet me pjesën tjetër të skuadrës. Sllovanaku ka plot 21 ditë në karantinë dhe virusi nuk po i largohet ende, duke krijuar një situatë aspak të mirë. Interi është kushtëzuar shumë nga virusi në këtë fillim sezoni, teksa përveç skriniarit pozitiv kanë dalë edhe Young, Bastoni, Galjardini, Radu dhe Naingolan, të cilët gjithsesi tashmë kanë dalë negativë.

Van Dijk operohet me sukses

Mbrojtësi i Liverpoolit, Virgil Van Dijk, është operuar me sukses në gju pas dëmtimit të rëndë që pësoi në ndeshjen kundër Evertonit pas një përplasjeje me portierin Jordan Pickford. Mund të ketë përfunduar sezoni përmbrojtësin holandez, por 29-vjeçari shpreson që të paktën të jetë gati për "Euro 2020" me Holandën kompeticion që do të nisë qershorin e ardhshëm.

Mbappe paralajmëron PSG-në se dëshiron të largohet

Kylian Mbappe dëshiron të largohet nga PSG-ja, raporton "OK Diaro". Sulmuesi francez i ka konfirmuar klubit aktual se dëshiron të largohet pa pasur telashë me drejtuesit e klubit. Interesim të vazhdueshëm për Mbappen ka shfaqur Real Madridi, por edhe trajneri Jurgen Klopp dëshiron në Liverpool reprezentuesin francez.



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han

05/10/2020
30.10.2020

Në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 nenit 8, Ligjt për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114 pjesa VII, dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Hanit të Elezit shpallë:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR

I.Titulli i vendit të punës: Shtëpiak/e Administrativ

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Departamenti/Drejtoria: Drejtoria për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport

Lloji I pozitës: nëpunës administrativ

Numri I Pozitave: një (1)

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i IP-së

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 5

Orët e punës: 40

Kohëzgjatja e emërimit: pa afat të caktuar

1.Detyrat dhe përgjegjësitet e punës për Shtëpiak/e Administrativ:

- Bën furnizimin e IP-së me gjithë materialin e nevojshëm.
- Mban evidence të saktë dhe të plota të mallit në kopje fizike dhe elektronike dhe ruan të gjitha të dhënat relevante të mallit;
- Bën pranimin e mallit, kujdeset përmirësimi dhe bën shpërndarjen sipas kërkesave; Vleron dhe kujdeset përmirësimi dhe nevojshme përmirësimi të deponim të mallit dhe përgadit planet e deponimit të mallrave të ardhshme;
- Të ndihmojë drejtorin në administrim, drejtim dhe në të gjitha aktivitetet e IP-së;
- Kryen edhe detyra tjera në përpunëje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkoohen here pas here nga mbikëqyrsi;
- ...

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

-Të ketë kualifikim superior;

-Shkakthësi kompjuterike të aplikacioneve të programave (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);

-Aftësi përmirësimi të detyrave dhe punëve nën presion;

-Aftësi në komunikim me kolegët e IP-së

Dokumentet e nevojshme:

Diplomë e Fakultetit (kopje e vërtetuar);

Dokumenti personal (kopje);

Dëshmi që nuk jeni nën hetime ose procedurë hetimore;

Rezumeja personale (CV);

2.Titulli i vendit të punës: Kuzhinier/e

Institucioni: Komuna Hani i Elezit

Departamenti/Drejtoria: Drejtoria për Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport

Lloji I pozitës: nëpunës administrative dhe mbështetës

Numri I Pozitave: një (1)

Titulli I mbikëqyrësit: Drejtori i IP-së

Grada/Koeficienti: Koeficienti – 4.8

Orët e punës: 40

Kohëzgjatja e emërimit: pa afat të caktuar

2.Detyrat dhe përgjegjësitet e punës për Kuzhinier/e

- Gatimin e ushqimit për institucionin parashkollar
- Përkujdeset mirëmbajtje ne pajisjeve të kuzhinës,
- Shpërndarjen e ushqimit përmijët e institucionit parashkollar
- Kryen edhe detyra të tjera të cilat ia cakton drejtori i IP-së

Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

Diplomë e shkollës së mesme;

Certifikat e trajnimeve të kryera përlimin e kuzhinës (e preferuar);

- Aftësi përmirësimi të detyrave dhe punëve nën presion;

- Aftësi në komunikim me kolegët e IP-së

Dokumentet e nevojshme:

Diplomë e Shkollës së Mesme;

Certifikat e trajnimeve përlimin e kuzhinës (e preferuar);

Dokumenti personal (kopje);

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbeten i hapur 15 ditë nga data 31.10.2020 deri 14.11.2020 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit e marrin pranë Qendrës për Shërbime me

Qytetarët në Han të Elezit katër i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në

intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në mjetet e informimit, dhe tabelën e shpallojve.



CN.nr.19/2020

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe sekretaren juridike Afërdita Ejupi, në procedurën jokontestimore, sipas propozimit të propozuesit Mehdi Nuhë Berisha nga Prishtina, rr. "Afrim Gjuraj" nr., për provimin e vdekjes së personit Habibe Adem Berisha nga fshati Majac, Komuna e Podujevës, më dt.23.10.2020, publikon këtë:

S H P A L L J E

Habibe Adem Berisha nga fshati Majac, Komuna e Podujevës, e lindur më 06.04.1902 në fshatin Sharban, nga babai Adem, supozohet se ka vdekur më datën 01.09.1995 në fshatin Majac, Komuna e Podujevës.

Thirret vet Habibe Adem Berisha nga fshati Majac, Komuna e Podujevës, ose kushdo që din diçka për personin, për kontaktet, përvendodhjen, menjëherë të lajmëroj Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, zyra nr.13.

Nëse në afatin prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh, nga publikimi i kësaj shpallje në gazetën zyrtare, si dhe në vendet tjera publike, nuk lajmërohet vetë personi Habibe Adem Berisha, ose nuk lajmërohet ndonjë person që din ndonjë informatë për të, gjykata do të bie aktvendim sipas propozimit për konstatimin e vdekjes.

Nga të lartekurat u vendsi më lartë, në bazë të nenit 73 dhe 74.1 dhe 74.2 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË

CN.nr.19/2020 më dt.23.10.2020



Lumé's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumé's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bayram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Golden Health Care" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811366071 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Golden Health Care", D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 811366071, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Golden Health Care" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. Unik Identifikues: 811366071, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Naser Saliu shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.
- Xhezahir Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- Petrit Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e vitit, I-II SHMLT "11 Marsi" Prizren.
- "Ndertimi-B" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811424738.
- Bastri Sheqiri shpall të pavlefshme katër dëftesat si dhe certifikatën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- Shkodran Berovci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- Ali Gagjeri shpall te pa vlefshme diplomën e Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari" ne Gjakovë.
- Jap banesë me qira afér 60 m², katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentishët kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo, a yellow box contains the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS'. To the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle. On the left, a dark blue sidebar lists 'Quality & Sales Award Recipients' in yellow text, with a note '(Listed in alphabetical order)' in smaller text below. The recipients listed include ARC Refreshments Corporation (Philippines), Embotelladora Central S.A. (Paraguay), Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. (Guatemala), Fluidi Sh.p.k. (Kosovo), Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda (Brazil), Interbrand S.A.L. (Lebanon), Kofola ČeskoSlovensko a.s. (Czech Republic), Obi Zulol CJSC (Tajikistan), Partex Sales sales Beverages Ltd. (Bangladesh), and Soft Drinks Georgia (Georgia).

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales